

Ndue UKAJ / KRIJIMI I DASHURISË

Biblioteka: HEJZA
Redaktor: Shaip EMËRLLAHU
Ballina: Majlinda KELMENDI

Ndue UKAJ

KRIJIMI I DASHURISË

Poezi të zgjedhura



Tetovë, 2017

E DIELA E LAURËS

Në qytetin e saj është një katedrale e rrënuar.
Ajo qëndron mes gërmadhave,
i mungon kori dhe kënga “Ave Maria”.

Skajeve të rrugës gurët lëshojnë dhimbje
veç gjurmët e korit duken
bashkë me buqeta lulesh të vyshkura.
Aty ka shumë qen e mbeturina,
është edhe një piano e madhe pa vendqëndrim.

Në qytetin e saj është një katedrale e rrënuar.
Atë e zgjon malli për tingujt e kabanave
e vesh një fustan t’ bukur dhe Ave Maria-n e pëshpërit në vetmi.

Ajo ka zërin e ëmbël, çdo të diel shkon tek rrënojat e saj,
flet me gurët, me lulet që nuk çelin lehtë nëpër mbeturina.
Dhe i fshin sytë e gëzuar pa e provuar zërin n’ kor.

Është e diel dhe pushon syri i saj i hareshëm;
Ave Maria-n e këndon n’vetmi.

Me gomën e dashurisë

fshin faturën e kohës që e le mbrapa
dhe i bashkon duart mbi gjinjtë e saj t'bukur.
Në heshtje e hap fletën e re
Ku shkruan një varg pakuptim.
Është e diel. Ajo zgjohet dhe andërron tempullin e dashurisë,
Tingujt e këngës Ave Maria është gjallë.

Dhe pret m'u zbukurua natyra,
ashtu si zbukurohet lulja me tanë bukuritë e saj
dhe m' iu bashku korit të jetës.

Ajo ec nëpër rrënojat e katedrales dhe e ndez një qiri,
ndërsa gjunjët e bukur i prekin gurët fort.

GODO NUK VJEN

Është furtunë. Rruga nga Irlanda është e pakalueshme.
Deti nuk kalohet me hapa t' vegjël netëve me shi,
Kur vetmia t' përpinë si toka e plasaritur nga tërmeti.
Kur dhimbja s'ka kohë e as deshifime shkencore.
Godo nuk vjen. Është vonë e pritja e ka molepsë.
Në gjumë t' rehatshëm i përkund ëndrrat e mia dhe ëndrrat tua.
Ai nuk vjen as nën Pemën e Jetës as në teatrin e çudirave.
E bën gjumin e pritjes që s'e kupton koha jote e koha jonë.
Megjithatë ti e pret;
E pret si nusja dhëndrin në shtratin e braktisur.
Dhe ëndërron krahëhapur thesin e mbështjellë me ëndrra
Ku ti i fut duart butësisht, prehesh si nëpër flokët e dashura.
Dhe kërkon ëndrrën tënde, që ngatërrohet nëpër gishtërinjtë e gjatë.

Pa pritë një pickim ta shtang trupin e dora jote fluturon nga thesi.
Pastaj ti fshin ballin dhe kupton:
Godo nuk vjen e as shikimi i tij enigmatik.
Prapëseprapë s' bindesh se ëndrra jote mbeti n' thes,
Nyje e përjetshme si ardhja e Godosë.
Atëherë si vetëtima kalon përtej lumit t' fjalëve.
Si hapat e tu nëpër ëndrra plotë çudira, ku janë rojet e kohës.
Që bëjnë zhurmën e jetës në ëndrrën e pritjes.
Megjithatë ti kultivon shpresën se Godo do të vjen.
Jo. Godo nuk vjen.
Ti qan furishëm sa lotët të çelin një përrua
Mes mollëzave tua dhe rrjedhës së tyre pa cak,
Ku tiktaket e zemrës ndjehen sikur hapat e të panjohurit
Në natën e zezë si futa kur troket hidhërimi
Në të cilën edhe Godo do të merrte në thua dhe përplasej keq.

GODO VJEN

Mos qaj furishëm.

Furtuna ka pushuar e rruga nga Irlanda është e kalueshme.

Ai ka zbutë shikimin e trazuar dhe zemërimin akilian

Edhe dhimbja e gjoksit i ka pushuar.

Ai vjen nën Pemën e Jetës ku ti ke krijuar follenë e pritjes

Me një kënetë dëshirash t'lidhura lak.

Godo vjen me tingujt e detit në heshtje

Sepse pritja jote e ka trimërua.

Ai vjen me thesin e enigmave

Pranë pemës që është kalbë

Ku ti pret m' i futë duart e dridhura

Që t'i kafshoi ironia e pritjes pafund

Dhe fjalëve që ndërronin trajtë çdo mëngjes.

Sythy yt i blertë s'i beson kohës, as pritjes-

e as ardhjes së tij.

Me dushkun e pemës thurë kurorën e fitores,

E me shpresa të reduktuara deri në mosbesim e tret shikimin.

E heshtur kalon nëpër lumin e rrëmbyeshëm, pushon larg në yllësi.

Por papritur e kthen rrugën në gjysmë

Dhe ulesh me mërrola zjarrndriçuese,
Afër Pemës ku dritat e bardha ta thithin shikimin e përmalluar.
Ku ruan nostalgjinë e pritjes e hapin e zemrës.

Me gishtërinjtë e lodhur dhe shikimin e mërzitur
Kallëzon dramën e fatit tonë,
Me shumë aktorë pa maska, pranë të cilëve,
Spektatorët janë shpërnda meridianëve të vdekjes
Duke e pritë Godonë.
Dhe frikën nga gjarpri nëpër trupin e pemës së kalbën.

Godo vjen nën Pemës së Jetës sepse pritja jote e ka trimërua.
Me trupën e aktorëve që ndërtojnë teatrin e shpëtimit për ty, për
dramën tënde,
Dhe për kohën e pritjes që zgjat sa ardhja e tij.

GODO ERDHI

Është natë e bubullimat s'kanë të ndalur.
Ty të dridhet trupi i lagur nga shiu i rrëmbyeshëm
Nën Pemën e Jetës duke pritë Godonë.
Pritja t' ka shndërru në statujë moderne
Ku folenë e jetës e kanë korbat e natës e zogjtë vetmitarë.
Vetmia jote është strukë si gjarpër i lidhur
Mes së cilit përbirohet gjuha helmuese.
Atëherë dëgjohet një e trokitur e furishme. Por ti s'e dëgjon.
Veshët t' janë mbyllë nga krimba që ngjiten trupit tënd.
Si plakut para Derës së Ligjit në tregimin e Kafkës.
Dhe pret të hysh në misterin e Ligjit, më fal, të Godosë desha të them.
Zot im! Godo erdhi me shikimin e mërrolur e thesin e shkyer.
Me dëshira të humbura gjatë rrugës së gjatë të kthimit
Nën Pemën e Jetës ku e prite pafundësisht.
Ti s'e njohe!
Ai erdhi me trajtat e një fytyre që s'e kishe imagjinuar kurrë.
Me zërin e lodhur që s'e kishe dëgjuar kurrë,
Me shikimin e trazuar që s'e kishe parë kurrë.
Trishtimi ta shtang trupin e krimbat përplasën tokës
Nga trupi yt i shndërruar në pritje.
Trishtueshëm kape kokën e llastuar dhe u përplase pas thesit të tij
Ku kërkove dëshirat tua të thara si gjethe vjeshte
Nëpër të cilat shkelin këmbët e dehura.
Atëherë lotët vërshuan faqeve tua dhe qafës tënde.
Dhe u hodhe në krahët e dëshpërimit.
E prite si nusja dhëndrin në shtratin e braktisur,
Duke ëndërrua krahëhapur thesin e mbështjellë me ëndrra
Ku ti fut duart butësisht si nëpër flokët e dashura, prehesh aty.
Dhe kërkon ëndrrën tënde që ngatërrohet nëpër gishtërinjtë e gjatë.
Fshin ballin dhe kupton: Godo erdh dhe pritja jote mbeti pritje.

EMIGRANTI

Ai ka vetëm pyetje. Përgjigjet i ka të ndrydhura
Nëpër xhepat e ndotur me nostalgji të betonuar.
Ai ka vetëm kujtime dhe ato i sillen rreth qafës
Si guri i mullirit e tundin një hapa para e disa mbrapa.
Në ujëvarën e rrëmbyeshme e frushkullon kujtesa.
Dhe ia rrëmben kohën- kohën që s'ë sheh kurrë;
Kohën që vetëm e ëndërron netëve pa fund.
Ai s'është njëri nga ata nën qiellin plot furturna,
Ku ec, ha, bën dashuri e lutet.
Atdheu i shpendëve është qielli
I peshqve deti
I emigrantit është pikëllimi-
Që i shumëfishohet, si shumëfishohen retë kur tërbohohet qielli.
Në rrugët e panjohura përkund nostalgjinë
Dhe kërkon njëshin n' zerot e pafundme.
Testamenti i Odiseut i digjet n'dorë,
E gacat e kallin flakë si rreze tropikale.
Në Itakën e munguar hedh shikimin
Mbrëmje e mëngjes rropatet.
Ai shtegton rrugëve t'pikëllimit
Dhe mbulohet me jorganin e Tokës së Premtuar.
Çdo natë ëndërron t' njëjtën ëndërr: kthimin në njësh.
Teksa oaza e shkretëtirës ia thith dëshirat, kujtimet.

Emigrantit kjo dhimbje e madhe.
Me thesin e pikëllimit bredh rrugëve t' shpresës
Pret vendime të bahet njësh n' zerot e pafundme.
Çdo ditë e presin të panjohura në pyllin e dëshirave,
Ku i prehet shikimi i butë dhe pritja e thellë.

Emigrantit kjo dhimbje e madhe
Si zog i mërdhirë kërkon folenë e shpresës.
Dhe mbulohet me jorganin e Tokës së Premtuar

VAJZA QË E DO POEZINË

Ajo lindi në ditën kur s' duhej,
Qyteti kundërmonte aromë t' keqe
E zogjtë kishin ra në qetësi t' detyruar,
Aroma e luleve ishte mbytë nga duhma e shurrës.

Vetëm zhurma e aeroplanëve dëgjohej
Dhe shushurima e korit t' kohës,
Ku kanë zënë vend politikanët me xhepat plot parulla.

Koha ikën.

Mes nesh kryelartë rri jeta jote

E ëndërruar çdo natë.

E ne, t' hutuar, shikojmë sytë e saj, si pikturojnë nëpër vite,

Ato kujtime të shpërndara si flokët e shprishura në trupin tënd.

Pastaj shtrojmë pyetje të shumta,

Pyetje që u mungojnë përgjigjet

Ditëve kur shfaqen njerëz me shikime t' mjegullta

Dhe duar të ngritura nga qielli që kërkojnë mëshirë.

O Zot,

Në qytetin e saj, ka shumë bërllok

Ajo e do poezinë, por s' i lexon përrallat patriotike

Ajo i pi kafet e zeza, por me një gotë raki

Ajo e ka fustanin e zi, por mendjen e bardhë.

O Zot, ç 'predikime dëgjon ajo, me veshët e bukur,
E sytë e stuhisë që i shohin përtej mureve.

Ajo bën plane për të nesërmen
E fustani i kapet në një gozhdë.

Pastaj qetësisht kërkon fundin e gjërave pa e kuptuar rrugën e
daljes
Dhe kështu i shterret fjala dhe shtegton nëpër imagjinatë.

Në vetmi kërkon Kullën e Babelit,
Në një ditë kur tullat i përplasën nëpër gishtërinjtë e saj.

VAJZA QË LEXON KOMEDINË HYJNORE

Ajo shëtiti e vetmuar në pyllin e dendur;
në pyllin e errët pa porta dalje,
kërkon gjurmët që s'janë
mbas një shiu të rrëmbyeshëm.

Përballë lisave, uturimës së ujqve
dhe një dashurie që e shtrëngon n'gji
papritur ndien se malet kanë mendime.

Herë përdridhet pas një lisi të gjatë si balerinë
Herë shtrihet në barin e njomë si një lis i rrëzuar
Dhe ndjen peshën e shtrëngatës.

Duke synuar m'u ngritë në naltësi,
këmbët i ndalen nëpër lisat e rrëzuar.

Ajo shëtiti e vetmuar në pyllin e dendur
S'ka dorë dashnori që ia prek flokët e bukura
Gjinjtë e ëmbla.
Mbi supe ka vu një shall me ngjyra
e në dorë e mban Komedinë Hyjnore.
Flokët i fërfëllijnë si valë deti.
Pastaj mes gjinjve të bukur e shtrëngon Komedinë,
dhe kërkon rrugën e kthimit
nga beteja për të njohur ma mirë vetveten
para se të hyjë në pyllin e vetmisë
në luftën për t'u liruar nga robëria e mosqenies.
Me librin e Komedisë Hyjnore në dorë.
Ajo e përkund andrrën për fitoren e panjohur
që e pret tash e sa kohë.

MALL

Mbramë kam pasë shumë mall.
Me pà lirinë pa veshje,
Pa gardianë,
Sikur ty kur të shndriste dielli
Mes malit e detit
Krejt pa cohë.

Mbramë kam pasë shumë mall.
Me të pà ty si lirinë e maleve,
Lakuriq,
Hapsinave të pafundme.
Mes atyne fushave të gjelbra
E detit të heshtun.
Me të pà
Si zanë e shkëputun nga qielli.

Mbramë kam pasë mall,-
Shumë mall:
M'i dashtë e m'i harrue
Anmiqtë e lirisë.

GJITHMONË DIÇKA MUNGON

Njerëz me fytyra të zbehta shtrëngojnë paqartësinë.
Ata kërkojnë diçka, sepse gjithmonë diçka u mungon.

Pas këtij shiu të zyrtë si pikëllimi, ka mundësi që nesër dielli kthen shikimin,
Dhe ne vazhdojmë mosmarrëveshjet tona. Kërkimet tona.

E sheh: dielli sërisht thyhet nëpër kodra dhe lind diku tjetër, si një rrëfim i ri shprese.

Megjithatë ti heshtur si paqja qiellore kërkon rrugëve të botës:
Itakën apo Penelopën e shtrirë me dëshira të paqarta,
Kujtime të trishta e net pa gjumë. Një tokë të premtuar
Ku do ta vendosësh kokën tënde e dhimbjet e tua.

Çka gjen!
Rrugë të mjegullta,
Tokën e Premtuar mbushur me gjarpërinj.
Ku s'ka tambël, mjaltë e as vend për këmbën tënde.

Gjen shtëpinë e pagjumësisë ku shoshiten ëndrrat,
Ku hahen ëndrrat dhe shpjegohet lumturia.

Ti gjithmonë kërkon diçka,

Dhe harron se gjithmonë diçka të mungon;
Të mungon rruga drejt cakut apo Itaka ku do të kthehesh.
Atje ku pret e trishtuar një grua
Dhe një qen që fle i trazuar pranë këmbëve të saj.

Ti gjithmonë pret diçka,
Dhe harron se gjithmonë diçka të mungon:
Shtëpia e ëndrrave dhe treguesit e lumturisë.

Ti kërkon rrugën drejt cakut,
E të duket vetja leckaman i gjuajtur me gurë.
Sepse ti gjithmonë kërkon diçka ndryshe,
Për shembull: një njeri pa syza të urrejtjes.

Dhe çka gjen!
Një rrugë dhe një kryq.
Ta japin kryqin e gozhdat t'i dorëzojnë,
E me to duan të mbysin miq e armiq.
Sepse ti gjithmonë kërkon diçka
Dhe harron se gjithmonë mungon.

TYM

Është mëngjes.

Lajmet e mira nuk vijnë si melodia e zogjve:
Na ishte njëherë pranvera, shpresa,
Dhe ideja se liria është mungesë e robërisë.

Tani ka tym e gaz,
E pranvera i ngjan vjeshtës.

Mbi kokat tona valëvit pikëllimi
Ky flamur morti që si një kortezh trishtimi
Bredh prej dore në dorë.

Lajmet e mira nuk u ngjajnë ëndrrave.
Shkruhen tuneleve ku mungon drita,
Aty ku terri shtrin pushtetshëm fuqinë
Mbi rojet e fatit-
Ata njerëz që luajnë në teatrin e demokracisë.

Qyteti fle i trazuar
Zgjohet i trazuar
Qan e qesh i trazuar.

Kafet janë mbushë më fantazma

Dhe kukurisje lajmesh që mbllaçiten keq.

Ka tym dhe një flamur pikëllimi
Që është shtri si shall dhimbjesh
Në qafën e rënduar të një populli
Që kërkon të pëlcasë nga trishtimi.

E unë mora me vete një thes ëndrra
Dhe dola rrugëve pa shpresa.
Pashë njerëz të shndërruar në hije
Dhe një pallat të vetmisë me rekuizita trishtuese,
Me mbishkrimin:
“Liria është mashtrim i madh.”

Rrugës shkelmova gurë të hedhur pikëllimi.
“Sa shumë marrëzi mban qyteti im mbi supe”-
Më tha vajza me shallin e bukur rreth qafës saj të ambël.
Dhe një çantë të zezë trishtimi që e mbante me vete.

KU ISHE, SALOMON?

Ai udhëtoi nëpër ëndrrën e dikujt dhe kërkoi dije e urtësi.
Pastaj e ndërtoi tempullin e fjalës me kokën në qiell.
Ndau drejtësinë mes dy grave që kërkonin amësi mbi të njëjtin
fëmijë,
Mirëpo s' u dashurua në asnjërën.

Demonët e prenë në besë dhe pastaj vallëzuan me engjëj.
Atë ditë vjeshta lëshoi shtat dhe një shtëllungë në qiell u përhap
deri në dhimbje-
Dhimbje për diçka që iku.

Ne kaluam mirë, pranë detit rrotulluam mendime.
Sa herë valët afroheshin te këmbët tona,
Ti më flisje e heshtur për magjinë e tyre dhe më pyesje:
Ku është kufiri mes zhurmës dhe qetësisë.

Megjithatë und dua ta di: ku ishte ti
Kur u nda drejtësia e padrejtë.
Atë ditë kur u vendos për demokracinë tonë
Për kufijtë që na rrethojnë;
Për historitë që duhet t'i lexojmë;
Për zgjidhjet tona që na hidhen në treg
Si zarzavate të prishura.

O qielli im i engjëjve!
Më dëfto
Pse nuk zgjerohen asnjëherë harta lirisë.

MBRETËRIA E DREJTËSISË

Harku pa formë i një pikë loti noton në qiell
Dhe u ngjan reve që grumbullohen mbi koka tona.
E sheh: ne jemi të barabartë në mesin e të pabarabartëve.

Ëndërrojmë drejtësinë e zogjve dhe mbyllemi nëpër konferenca të gjata.
Mbi to lexojmë drafte shterpe
Dhe nga “lehtësia e padurueshme e të qenit”
Ikim në ekzistencën e thjeshtë të episodeve të përsëritura.

Të tjerët veprojnë mbi ne
Më shumë se ne mbi dëshirat tona – m’tha gruaja
Dhe u zhduk në errësirë
Bashkë me fërfëllimën e fustanit të saj magjik.

E ti më thuaj nëse vërtet ekzistojnë hartat e drejtësisë
Apo janë shpikje imagjinare e poetëve?

NJË DITË VJESHTE SI KJO

Lajmet e fundit fillojnë si përrallat e bukura:
Na ishte njëherë shpresa dhe qyteti i gëzuar
Tani ka tym, mjegull e gurë pikëllimi.

Njerëzit shëtisin të hutuar.
Pinë kafe bashkë me fantazma
Dhe rrëfihen para tyre si Konstandini kur e sillte Doruntinën te
ëma.

Nëpër rrugët e ngushta mendimet janë të ngushta,
Dhe marrin n' thua edhe ata që sytë i bëjnë katër.

Na ishte njëherë një kohë kur lirinë e prisnim nga lajmet.
Tash lajmet na dëftojnë hijet që kukurisin dhe njollosin lirinë.

Përtej horizontit në malet e thepisura
Shihet dëborë dhe një dimër i acartë pa fund.
Oh! Në një ditë vjeshte si kjo,
Me lirinë e tepruar të imagjinatës
Shoh gra të bukura
Që luajnë me gjethe vjeshte.
Dhe matanë ekraneve një çetë politikanësh
Si bëjnë plane të mjegullta.

Një ditë vjeshte si kjo:
Njerëz pa skrupuj shëtisin rrugëve të boshatisura
Ata kanë abortuar lirinë
Dhe shfaqen çdo mbrëmje në ekranet tona të mëdha.
Na dëftojnë si formohet mbretëria e marrëzisë
Para syve që s'ohohin gjë nga mjegulla.

Një ditë vjeshte në fund
Ndala orën dhe nëpërmjet dritares
Pashë silueta njerëzish të mërzitur
Një qytet të mërzitur
Gra të mërzitura
Fëmijë të mërzitur
Dhe një grusht politikanësh të lumtur.

PORTAT E LIRISË

Ajo zgjohet me veshjen e bardhë të natës,
E mendja i fluturon kudo ku banon kuptimi.
Në trenin e parë shfleton gazetën që shpërndahet falas,
Dhe falas merr ato që s'i duhen.
Miku i saj i habitur i tha:
“Portat e lirisë i kanë dyert e çelikosura,
E çelësat i ruajnë zuzarë e kusarë.”
Asaj i rritet dëshpërimi si retë në një ditë dhjetori mbi detin Adriatik.
Askund s'ka qartësi as kthjelltësi.

Në zemrën e saj është shtri një njollë.
Përnjëmend: a është liria me porta? -pyet dhe mbyll gazetën.
Treni paralajmëron stacionin e radhës,
Ku ajo nuk duhet të ndalet.
E pret caku tjetër- qëllimi i pafund që asnjëherë s'e arrin.
Pastaj psherëtiu dhe tha: trenin s'e pengon mjegulla.
Ai gjarpëron me furinë e tij dhe mbush natyrën me atë që i mun-
gon: zhurmë.

Mëdyshja e saj s'ka pronar.
Është një rrebesh lajmesh që shkruhen keq
Për kohën e saj.

Në mbrëmje në vendin e saj ka zgjedhje.
Lexon Hamletin me zë dhe dëgjon tingujt e zogjve të mërzitur.

Akrepat e orës lëvizin furishëm në murin e pritjes.
Ajo nesër zgjohet njësoj me veshjen e bardhë të natës.
Është dita e demokracisë- thonë lajmet,
Por portat e lirisë janë mbyllë.
E çelësat i mbajnë në duar ata që të zotërojnë ty, liria ime-
Klith habitshëm
Dhe pret të ndalet në stacionin e harruar.

MESDITË PRANVERE

Pas këtij dimri të acartë,
Kjo ditë ka nevojë për qartësi.

Vitet tona janë shpuar tej për tej nga kjo re pikëllimi
Që sodit mbi pranverën tonë tash e sa mote.

E sheh: unë e hodha pallton e palarë
Dhe gradualisht i afrohem diellit.

E matanë kësaj stine
Ata flasin për pamjaftueshmërinë e sendeve
Dhe një ditë që zgjat sa një jetë.

Pas këtij dimri të acarët
Pa dyshim
Kjo ditë ka nevojë për frymëmarrje dhe shumë kthjelltësi.

POEZI

Në këtë kopsht dikush mbjell lule
E dikush therra.

Dikush shkruan për dashurinë
E dikush për urrejtjen.

Dikush vërshëllen e dikush mëkon dhimbje.

Mbi të shkronjat dridhen si ti nga dashuria.

Aty ka lule të bukura gëzimi e pikëllimi.
Një buqetë e përherëshme për ata që s'e duan rregullin, stolitë.
As drejtësinë e padrejtë.

Aty shkronja vdesin përditë bashkë me dashuritë e dhimbjet,
Dhe bëjnë që të qajë e qesh qielli.

Aty metaforat hyjnë në shpirtin e sendeve, si ti në mëngjesin e ri.
Dhe rrëfejnë himnin e jetës, me gazim e dashuri.

ITAKA SËMBON

“Unë jam e huaj në vendin tim”, shkruante Edith Södergran.
S’di si do të jetë ndjerë ajo atë ditë kur frynte erë dhe binte borë.
Ajo sigurisht fliste për Itakën apo për mungesën e përhershme.
Një dhimbje që përbirohet dhe si shigjeta sëmbon.
Në të vërtetë ajo mund të fliste për mungesën e Itakës,
Për mungesën e ngjashme si atëherë kur Odiseu i afrohej limanit
Dhe s’dinte kush ishte në pallatin e tij;
Kush e shoqëronte Penelopën e ç’ndodhte me qenin e tij.

Fryn dhe bie borë.
E një grua ec ngadalë, ka frikë se do të rrëzohet.
Qartësia mungon gjithkund.
Në kohën kur sytë ngashënjehen nga portat e mbyllura.
Nga Itaka-
Dhe një grua që pret e rrethuar me imagjinatë e vetmi.

Ne gjithmonë synojmë të arrijmë te caku nëpër dallgët që rriten.
Ah! Ç’është caku?
Një shpikje e askujt apo e fuqive të mbinatyreshme-
Cakun që kurrë s’e arrijmë.

Edith shihte një pemë ma të madhe se gjitha pemët e tjera.
Askund s’ishite gjarpri, as Eva e bukur.

E mira dhe e keqja ishin përzi si leshi në pubisin e saj.

Mjegull dhe bie borë.

Matanë kujtesës ajo ka frikë nga nata.

Muzikë s'ka askund. Është një mori zogjsh që cicërojnë.

Refrenet joshëse për të cilat përpëlitemi si nëpër ëndrra dimërore.

Fryn dhe bie borë. E gjethet e pemëve fëshfërijnë,

Si fustani i Penelopës kur u hodh në përçafim të Odiseut.

Kjo është muzikë për ata që duan qartësinë,

Dhe shmangen nga mjegulla, rregulli.

Unë kthej fytyrën kah rruga e re. Aty ku s'kam kaluar asnjëherë.

Dhe them: s'jam i huaji në vendin tim.

Pastaj e hapa përsëri librin dhe gjeta atë që Edith vërtet shkroi:

“Unë digjem për një vend që nuk është.”

ASGJË

Qershitë janë pjekë dhe s'janë të ambla si vitin e kaluar.
Babai im thotë sivjet pranvera ishte e vonuar.
E mua s'më pëlqen ky konstatim.
Atëherë hapa dritaren dhe pashë gjethet e njoma,
Ato ngjyra magjike si melodia e kërcimit tënd.
Dhe rrezet e diellit që përthyheshin nëpërmjet degëve të pemës
Kah pellgu ku pija ujë si fëmijë.
Oh! Ç'mallëngjim!
Dhe përsëri mendova: ka shumë rrugë që kurrë s'i shkelim;
Ka shumë dhimbje që kurrë s'i përjetojmë;
Ka shumë gëzime që kurrë s'i ndjejmë;
Ka shumë tregime që kurrë s'i kallëzojmë.

Mirëpo një dëshirë gjithmonë e mbaj ndezë
Si dritaren për ajrosje para ndjenjave pa formë.

Kodra mbi shtëpinë time buzëqeshë çdo mëngjes
Kur përshëndetet me rrezet e diellit.
E unë hapëroj nëpër pemët e shumta
Dhe mbush ujë në kronin e fshatit
Aty ku pinë ujë prindërit e mi
Aty ku pinë ujë fëmijët e mi.

Dikur s'dija asgjë për Heraklitin,
As mësimin se vetëm njëherë mund të lahemi në të njëjtin ujë.

Tash shtrij hapin përpara dhe them:
Ka shumë rrugë që kurrë s'i shkelim,
Mirëpo disa tregime gjithmonë na thërrasin:
Kah portat e ndërgegjes si shkohet?

DILEMË

Mendimet e varura si këto gjethe të zverdha vjeshte
Rrinë në ballin tim dhe krijojnë mozaik dilemash-
Korniza të një pikturë që ti s'e bën kurrë.

Papritur një zog bredh pranë dritares sime
Dhe një mendim kërkon shteg në kokën time.
Si kërkon njeriu të lirohet nga vargonjtë e shëmtisë
Ato pranga shpirti.

Ne e dimë se asgjë s'i ngjan asaj që e pritëm,
Asaj që deshëm.
Në tatëpjetën e kësaj mjegulle
Rrëfej veten
Derisa akrepat e orës më dëftojnë:
Është mbrëmje dhe ti s'je askund,
As melodia e zërit tënd.

I strukur në vetminë time kujtoj mësimin:
Drita s'është për t'u fshehë në magje.

Pastaj e hapi dritaren dhe zogu vjen në krahët e mi.
Ai ka shikimin e hutuar,
Ma shumë se shikimi im varur në gjethet e kalbura

Prej ku noton në zemrën e trishtimit.

Matanë hijes

Ti pret me ngjyra në duar të bësh pikturën e jetës.

Nuk di: për mua apo për zogun?

Unë s' e di si ngjau që ti ta thërrmoje kohën

Dhe t'i kërkoje dyert për udhëtimin e radhës në tempullin e fjalës.

Të rrëfesh në një hapësirë publike për paqen hyjnore.

Oh! Ti ke dy mundësi: ta vrasësh kohën apo ta fitosh përjetësinë.

Megjithatë unë s' dua ta ngul këtë shtizë në zemrën tënde.

Dhe refuzoj ta shumëztoj hidhërimin me gjithçka që s'i ngjan dashurisë.

SHESHI

Sheshi është rrëfim i pakryer
Që atëherë kur u dogj Troja
Dhe filloi beteja për të.
Natë e ditë kur Helena bënte dashuri
E Odiseu kërkonte rrugën kah Itaka.

Sheshi është rrëfim i pakryer
Që atëherë kur Diogjeni
Në mes turmës kërkonte njeri.

Sheshi është rrëfim i pakryer
Që atëherë kur turma shtroi lule
Për Krishtin në Jerusalem
Dhe e njëjta të nesërmen e kryqëzoi.

Sheshi është rrëfim i pakryer
Që atëherë kur turma rrëzoi shtatore prej bronzi
Dhe ndërtoi piramidë fjalësh
Për njeriun e ri.

Sheshi...
Rrëfim i pakryer dje
Rrëfim i pakryer sot
Rrëfim i pakryer nesër.

SIPËRFAQJA PA FORMË

Gjëra të pakuptimta ndodhin mes meje dhe teje.
Ushqehemi me mërzë,
Na pi errësira dhe ngremë dolli për yjet që s'janë.

Stolitë i heqim nga muret dhe në to varim gotën e idhtë,
Si pikturat e harruara të fatit tonë.
Pastaj lexojmë një vistër lajmesh për kohët e thyera si shtiza
Në sipërfaqen pa formë të kësaj fushëbetejë absurde
Ku prapa mbetet tymi dhe një arenë pasigurie.

Mes meje dhe teje është një humnerë
Ku veç zogjtë kalojnë të lirë.

Ah! Sa herë e theva pikëllimin
Si këtë shtizë që e mbajta gjatë në duar
Kur notoja pas zjarrit tënd.

Përsëri shikoj matanë humnerës.
Një pemë është e bukur dhe më tërheqin frutat e saj.
Përdëllehem para se të marrë frymë thellë.
Megjithatë nuk dua të besoj në follenë e gjarprit.
Jo! Ai nuk është aty as helmi i tij.

Pastaj ti e sheh: dielli bëhet pikë e vogël në horizont,
Ndërsa hëna shfaqet me sytë e mëdhenj.
Në këtë mesnatë kur s'e di a duhemi apo urrehemi.

VEGIME

Më sëmbon diçka si kjo mërzi oqeanike.
Si anije në dallgë kthehem drejt limanit të kujtimeve.
Aty është koha e pashkruar, kthimi i ngadalshëm.

Një zog këndon si më parë.
Është vjeshtë e hershme,
E gjethet e kuqërremta janë panorama e imagjinatës sime.

Dielli shtrihet mbi tokë e qyteti zgjohet zhurmshëm.
Anija ime i afrohet qetësisë.
Teksa një kabanë dëgjohet nga katedralja e qytetit të kuqërremtë
Dhe prish qetësinë e hutave.

Këtë mëngjes jehu i detit rishtas ma mbush gjoksin me një dëshirë:
Lirinë e peshqve.
Oh! Dikush tha: “kjo zonë është e ndaluar për peshkim.”
Por një anije luftarake shkeli ligjet ndërkombëtare
Dhe kushedi sa peshq vrau.

Ne zbresim poshtë e më poshtë.
Dielli shkëlqen dhe deti duket si kristal mëngjesor.
E nga toka dëgjohen notat e një melodie;
Një melodie që s’dua t’a deshifroj.

LUFTËTARI

Mërinë e Akilit askush s'e kuptoi
Derisa një det hidhërimi u përmbys në faqet e panumërta
Të një libri pa epilog.

Të kujtohet kur ai i veshi teshat e trasha të mërzisë
Për mungesën e diçkaje që quhet dashuri.

Pastaj braktisi lirinë e fushave
Fushëbetejën e përhershme.

Vrapoi shtigjeve të mjegullta
Dhe u preh pafundësisht në mërzë.

Me gishtat të mbushur me hidhërim
Në vetmi numëroi deri në dhjetë,
Në një ditë vjeshte kur gjethet kishin râ përtokë.

Ai nuk shihte askund vajza të bukura,
As aureolën e thurën për të.

Atëherë vrapoi si shigjeta në fushëbetejë
Dhe u ngul këmbëkryq në sytë e botës.

QIELLI I FRIKËSUAR

Në këtë rrugëtim kalvari
Poetët ngulin sytë kah sorrat e çartura.
E sheh: ato kanë mbushë qiellin me pasiguri.

Ne s' e kuptuam:
Tingujt e lirisë janë çakorduar nga dirigjentë të shumtë
Dhe një rrëfimi me heroizma
E pa histori.

Sikur dje edhe sot,
Ecim dhe nuk dimë kah shtegtojmë.
Në mes të kësaj mjegulle mungon diçka që quhet qëllim.

Këtu dikush u përpëliti, bërtiti llahtarshëm dhe iku si vetëtima.

Në fund të kësaj ecje është një fushëbetejë,
Dhe një vistër shkrimesh që tregojnë si shkohet kah caku;
Caku që kurrë s'e arrijmë.

Oh! Ti e di: askush nuk e meriton këtë udhëtim kaq të gjatë kalvari.
Sidomos tani kur fëshfërinë thellësia e malit
E sorrat e zeza mbushin qiellin me pasiguri.

SHKËLQIM I VAGULLT

Atë ditë...

Çdo gjë shkëlqente para këmbëve tona
Kur ti më afrove dorën e paqes.

Përnjëmend vetëm ti e di fshehtësinë e valëve gazmore
Atyre ndjenjave që heshtën si notat në pentagram.

Si mbahet jeta në këmbë
Kur ta kthen shpinën barka jote
Dhe e sheh si është nisur drejt shkëmbinjve.

Oh! Përnjëmend duhet të ngrihem mbi fishkëllimat e fatit
Dhe të dirigjoj melodinë e zogjve.

Barka ime është kthyer kur gjithë e shtynin në stuhi.

LUFTËRAT BALLKANIKE

Ato kanë një arenë të madhe
Sa pafundësia
Dhe një litar të fortë sa kokëfortësia e atyre shkëmbinjve.

Ato kanë veç heronj
Dhe një rrëfim të pakryer
Që e shkruajnë po ashtu
Vetëm ata që janë heronj.

Gjithmonë fillojnë me zero
Dhe mbarojnë me trishtim.

Në mes është sipërfaqja e dhimbjes
Një arenë përplasjesh
Pa shandanë drite
Ku mblidhen gratë dhe vjellin përditë mërzy.

FLAMURI I LIRISË

Imazhet e një fushëbeteje
Dhe litari i gjatë që mban një fustan të bukur
Janë pamje shëmtie para syve të mi.

Dikush tha: kaosin e mbajnë duart e lodhura me peripeci
Që kërkojnë zgjidhje të rëndomta
Për ekzistencën.

E dikush tjetër pavetëdijsëm këtë edhe mund ta quajë dosido liri.
Për mua s'ka rëndësi. Një figurë pa formë ndërron trajtë.
Dhe fluturon si zog në qiellin e errësuar,
Askund s' gjen fole.

Mirëpo pamja ime nuk ndryshon.
Atëherë ti rishtas më përsërite: liria i tremb hutat dhe diktatorët.

Në një rrugë të vetme pa shtegdalje
I thashë vetes: qenia banon në gjuhë
Por unë jo në metaforat e natës
Pa diell
Të lagura në shi.

Më duhet drita,
Në këtë natë kur qenia fluturon dhe kërkon strehim
Aty ku nuk ka burg për lirinë
As mërzi për zogjtë e pranverës.

GJYQI I PILATIT

Atëherë Pilati mori frymë thellë.

U ngjit në fron dhe i shtriu duart e palara ka qielli.

Ato formonin re pikëllimi dhe ngjiteshin në sytë e njerëzve.

Turmat e hutuara shikonin si demonët cakërronin gota

Dhe përgatisnin gosti për triumfin e tyre.

Atëherë një grua pështyu mërzi dhe iku nga aty.

Mirëpo prapë procesi vazhdoi

Me personazhe që ndërruan trajtë si ky qielli i egërsuar.

Pastaj aty u shfaq kupa e mbushur

Dikush priste të hynte në vallen e demonëve

Dikush në atë të engjëjve

Dhe të shkëputej nga turma.

Megjithatë Pilati i dha kahe procesit kur i lau duart

Dhe pushoi në vithet e gruas së bukur.

Atëbotë një shtizë u shkëput nga qielli

Dhe hyri thellë në zemrën e tij.

E ai mbylli sytë deri në pafundësi.

DALLGËT E JETËS

Ne qëndrojmë në plazh, e deti na lag këmbët,
Atje thellë janë misteret. Ne jemi në kufirin e tyre me tokën.
Kështu nis ëndrra e qetë trazimin para stuhisë.

Ikin zogjtë, gurët lëvizin nga vendi si lëvizin akrepat e jetës
në murin e pritjes. Dhe ashtu heshturazi si zakonisht në kufijtë e
madhësisë zëmë vend ballë për ballë.

Dallgët vijnë së pari, pastaj shikimi i trazuar.

E n' fund anija e braktisur.

Aty ku fjala humb pushtetin,

sikur dallgët që tretin qeniet thellë nën ujë.

Ku sytë tanë janë të pafuqishëm.

Ti ose frika jote m'i hedh duart në qafë.

Nëpër dallgët e mëdha kuptojmë rëndësinë e qetësisë-
më pëshpëritë dhe ma fshin ballin e djersitur,
ku rrezet e diellit kanë lëshuar shikimin e fortë.

Zoti im, lidhja mes dallgëve dhe qetësisë i shpjegon fshehtësitë

Këto mistere që ngrihen si merimanga

Nëpër diagramet e hierarkive absurde,

Aty ku copëzohet gjithçka,

Aty ku shumëzohet gjithçka.

Ku merr udhë fjala, si anija që çan tallazet e detit
Oh Zot, si rrapëllimat e hapave të pakontrolluar nëpër cungjet e
kohës.
Ulem unë. Ulesh ti. Shikoj qiellin unë. Ul shikimin ti.
E qeshura nuk është simfoni e dallgëve dhe valëve të qetësisë-them
unë e përsërit ti.

Aty ku përplasat koka ime që i nuhat sytë e botës
Aty ku përplasat koka jote që i kërkon sytë e botës,
Sytë që ecin zvarrë nëpër cungje tanë.
Aty ku shkëlqen pika e lëvizshme mes qiellit dhe tokës,
Ku loja luhet si nëpër pokerë shumëngjyrësh
Teksa arrijmë tek apologjia për dallgët
Duke klithur njëzëshëm:
Na duhen dallgët për ta kuptuar rëndësinë e qetësisë.

AROMA E SË VËRTETËS

Ajo kërkon përgjigje
Për dilemat e mëdha sa malet e pakapërcyeshme
Rri në një dritare t' hapur me shikimin lart,
Shumë lart mbi sheshin "Nënë Tereza"
Ku shëtisin bashkë europianë e aziatikë.

Dyshimi e trondit,
Ashtu siç tronditet njeriu pas një ëndrre plot makth
Në dhomën e errët, me identitetin e shartuar.

Ajo është e bukur,
Dhe i ngjan një portreti misteresh.
E thyhet duke kërkuar përgjigjen e amshueshme
Për pyetjet e përditshme:
Kush jam unë
Unë, a jam unë?
Apo hija e kohës që dëfton mbi mua
Ngjyrat, mallin, dashurinë e përjetësinë.
Dhe humnerën që rri pranë këmbëve të rënda.

Dritarja mbyllet. Mbyllen edhe sytë e saj,
Europianët lëvizin heshtur
Nëpër sheshin "Nënë Tereza"
Shqiptarët luhatën mes t'bardhës e t'zezës.

Pastaj çel portën e madhe të dilemave
Dhe pyet e trishtuar: kush jam unë?
Vetveten s'e gjen në shekullin e llahtarisë.
Shfleton librin e kujtesës,
Si shfletohet libri i zbuluar për të parën herë.
Kështu ik prej t'vërtetës
Dhe fshihesh si gjarpri në barin e dendur,
Dhe mediton: kush nuk dua me qenë unë?

UTOPIA

Çdo gjë është ndryshe. Në horizont dielli copëzohet;
Copëzat ngulen në zemrën e tokës si shigjeta triumfuese.

Ngjyrat s'i dallojmë nëpër erën që frushkullon kujtesën.
Poezi s'lexojmë në universin e marrëzive
Ku marrëdhëniet mes territ dhe dritës
Shfaqen si marrëdhëniet mes murit dhe mendimit.

Prapë luhet loja e çuditshme, njësoj si dikur
Zogjtë bien përtokë, si atë kohë kur u shkrua Ferri.
O Zot! Seç ka ndërruar çdo gjë
Në kohën kur gardhi i vogël errëson sytë e mëdhenj.

Hëna gjen rrugë nëpër duart e mpira që rrinë si shtiza drejt qiellit,
E dielli shkrihet si qiri nëpër sytë e lodhur të tokës;
Në sytë që s'shohin gjë në qiellin blu, veç një reje t' vogël;
Një re që errëson shumë.

Shikimi im përdridhet në hapësirë
Si përdridhet era dhe krijon ortekët e saj.
Pastaj shfaqen fytyra.
Në një natë, kur çdo gjë është ndryshe,
brenda së cilës kufijtë janë n' kokën tënde

aty ku këmbët tua ecin nëpër iluzione
aty ku këmbët tua rrëshqasin nëpër iluzione.

Në vetmi i shtrydh ëndrrat e këqija
për kohën që s'është
për kohën që s'ishte
për kohën që s'vjen
për kohën që ik me erën.

Çdo gjë është ndryshe. Në horizont dielli copëzohet;
Copëzat ngulen në zemrën e tokës si shigjeta triumfuese.

Utopia n' betejë me realitetin
ia ha ëndrrat
e struktura n'këndin e fshehtësisë.

DITA E RE

Zgjothem dhe qëndroj para dritares.
Ajo ashtë e hapur, si sytë e mi, si goja ime:
Si lulet që marrin rrezet e diellit n'këtë mëngjes;
Si kodrat që zhvishen nga nata e zezë
dhe shfaqin shkëlqimin mëngjesorë.

Një pemë është përpara, e n' ta ka shumë ngjyra,
Asht ngjyra e trungut, e gjetheve të njoma dhe e frutave
Që plotësojnë kuptimin e saj
ekzistencën e saj.

Unë zgjothem dhe qëndroj para dritares,
dhe shoh përballë pemën që është liruar nga robëria e natës.
Aty nuk je ti, as liri a jote.

Dritarja është e hapur
Pas është hapësira diellore,
Ku terri s'ka pushtet.
Për çudi, prapë ti nuk je. As liria jote.

Par një çast ngrys shikimin.
Vështroj para dritares dhe shoh mbas pemës
Kodrën e zhveshur nga errësira
Dhe hedh sytë në horizont.
Atje zhdukën kalimtarë
Me lajme të ndryshme për qytetin.

Ti s'je askund as liria jote.

Unë qëndroj para dritares dhe mendoj për dy të vërteta
Që ndeshën, si ndeshet syri im me kodrën që prek qiellin
Dhe pemën që rrënjët i ka thellë në dhë-
Në tokën që s'ngopet me ujë.

NË STACIONIN E TRENIT

Grumbuj njerëzish
vrapojnë drejtimeve të ndryshme
disa kanë valixhe
disa bartin në sy hutinë
disa trishtimin
disa presin trenin
e disa kthehen si Odiseu në Itakë.

Të gjithë gjenden në një vend
prej ku marrin drejtime të ndryshme.
E megjithatë gjithë kanë një qëllim:
cakun e jetës
o Zot, cakun e jetës së panjohur.

Ti fshin ballin dhe më zërin e ëmbël, pyet:
Ku është caku?

Odiseu kur u kthye n' Itakë,
Kuptoi sa larg ishte ajo prej ëndrrave të tij.
Aty kishte ndryshuar çdo gjë, veç kujtimeve të tij.
Ajo s' ruante t' freskëta as bëmat e tij;
ajo s' ishte Itaka e ëndrrave të tij.

ANIJA NË DALLGË

Është ditë e shtunë e mars i ftohtë.
Rrugët shkëlqejnë nga ngricat, qyteti është i heshtur.
Tingujt janë të frikshëm, si ushtima e maleve nga rrufeja.

Sot, lulet e ftohta kanë ngjyrën e akullit.
Asgjë s'ka shkëlqim, as aromë, as tingull, as fjalë;
në tokën e pangopur me ujë.
Ne nisemi te deti,
atje është një anije e vetme dhe një lundrar me maskë.

Lundrari la prapa qetësinë dhe niset nga brigjet,
hidhet në misterin e dallgëve të trazuara.

O Zot! Ti e ndjek me imagjinatën tënde rrugën e anijes.
Ajo çan stuhinë dhe s'i frikësohet bubullimave,
kur pëlçet qielli dhe vizaton pikturën e madhe të frikës.

E ti e trishtuar pyet: pse anija la qetësinë e brigjeve?
Atëherë e shikon e mërzhitur
nga pika prej ku ajo vogëlohet e dallgët rriten,
ashtu siç rritet trishtimi i paqartësisë.

Është ditë e shtunë e mars i ftohtë.

Rrugët shkëlqejnë nga ngricat, qyteti është i heshtur.

Sytë e tu marrin ngjyrën e akullit
dhe ti kujton tregimin e keq:
sa herë anija vogëlohet, sytë njerëzorë trishtohen.
Është e shtune, mars i ftohtë.
Lulet janë të ftohta sikur kujtesa jote
që le prapa qetësinë dhe hidhet në valët e jetës.
Aty ku është një humnerë mes dëshirave dhe realitetit
sikurse mes teje dhe të vërtetave
që s'marrin frymë, jetë as kohë
në tokën e pangopur me ujë.

FILOZOFIA E JETËS

Rrugët e kundërta më ndjekin si dëshirat e panjohura
Pas të cilave godet rrufeshëm pyetja:
Ç' është kjo jetë ku vijmë pa na pyetur?
E n' teatrin e së cilës e harrojmë tekstin.

Aty ku si nëpër skenat antike shfaqen maska aktorësh
Tek kënaqin publikun me shije të ndryshme
Dhe na kallëzojnë komedi e tragjedi përnjëherë.

Koha rrjedh si lumi në ujin e së cilës
Mund të lahemi vetëm një herë.

Pastaj vjen pendimi ose dëshira për t'u zhytur dy herë.
Kështu na kryqëzohen rrugët nëpër të cilat na ngatërrohen këmbët,
si i panjohuri mes një pylli.
Dhe pyesim të hutuar:
Ç' është kjo kohë nëpër të cilën shtegtojmë
Duke ia kërkuar domethënien me bebëza të ngushta
Duke ia kërkuar fundin me duar të vogla
Aty ku prehet shikimi i përhumbur nëpër rrugët e mjegullës
Bashkë me hapat e vegjël që konsumojnë kohën
Pa i takuar ato që i duam
Atëherë kur çdo gjë dukej e mirë
Çdo gjë e drejtë si udhëtimi ynë.
Duke i kërkuar rrugët e humbura, pyllit të errshëm
Pyesim të dehur:

Kërkojmë të vërtetat nëpër rrugët e rreme
Kërkojmë rrenat nëpër rrugë të vërteta
E asnjëherë s' mësohet arti i dashurisë.
Të vërtetën se dielli lind për të mirët e të këqijtë njësoj.
Humb në betejën e përhershme
Që ndërron trajtat, ngjyrat, format
Në betejën e njëjtë, të luftës mes territ dhe dritës.

TOKA E PREMTUAR

Shtegtari i dritës
nëpër terr e përshkon shkretinën dhe mbas ka një lum.
Ura është e shkatërruar
e sytë i janë i janë lodhë.
Përtej,
përtej larg është Toka e Premtuar.

Shtegtari i dritës në dorë ka dy rrasa
dhe prapa turmat që s' shohin e s' dëgjojnë.
Si turmat e qytetit tim.

Atij i dridhen këmbët para kaçubës së zjarrtë
Sa herë i premtohet rruga ka lumturia.

Rrugët janë bosh, si qyteti pa kulturë.

Aty kultet e kohës janë të mëdha
sa viçi i artë e sa kuvendimet pa kuptim.
Aty arka e besëlidhjes është pa udhërrëfim.

ARKA E NOES

Arka e Noes s' u zbraz as kur ylberi shkëlqej mbi det,
ernat pushuan e deti ra në gjumë.

Ajo s' u zbraz, as kur pëllumbi i bardhë kaloi para saj
e nëpër dyert e ngushta brofën të pasionuarit
m' i prekë gjitha ngjyrat e shkëlqimit përnjëherë.

Ajo e dehur lufton me stuhinë
shiun e jetës që bie pa pushim
me bataqçinjtë që tokën e kanë dhi.

Qysh atëherë kur njerëzit e dehur i pushtoi dëshira
m' u kacavjerrë nëpër ngjyrat e ylberit,
më beso, paqja s' u shtri mbi ne
as kur pëllumbi u shfaq qiellit blu
kur ty të kapi dëshira m' u dehë në buzët e afshme,
me vdekë aty e me ruejtë çastin e fundit për përjetësi.

Prapë ra nata.

Prapë ylberi u zhduk në orbitën e errësirës,
si i panjohuri pas një kodre të madhe.

Prapë ra nata,

e terri pushtoi sytë e tanë, ashtu siç u pushtua Eva nga dëshira për
mollën e ndaluar pjekur në Pemën e Dijës.

O Zot!

U humb shija për frytin e jetës

Qysh kur arka lufton me stuhinë!

KUR PRISHET PAQJA BIBLIKE

Ndodh ndonjëherë mos të kuptohet kufiri mes natës e ditës
As mes t' mirës e t' keqes.

Ndodh ndonjëherë rrugët ngatërrohen
Dhe në pështjellimin e madh s' dallohen ngjyrat
Krejt kjo ndodh sepse shuhen dritat n' horizont.

Papritur, si në një skenë teatri hapet një perde
Skena është bosh, e thatë, e ftohtë, e errët...
Sikur një jetë e fshehtë plot mistere,
Dhe një i penduar që rrëfen vetveten
Pa fund e pa fillim.

I kredhur në kontekstin e rutinës
Pa liri, as me robëri
Ndodh ndonjëherë njeriu s' ka horizont
Dhe çdo gjë përmbysset
Sikur para një cunami që merr përpara gjithçka.

Ndodh ndonjëherë, njeriu s' ka lartësi as thellësi
Ndodh t' kujtojë se s' ishte asgjë, s' ishte askund
S' ishte askush...
Në botën që fundoset në sytë e tij pa horizont.
Dhe thotë: gjithçka ekzistoi si në një ulërimë të frikshme.

Po, ndodh ndonjëherë, njeriu dëshiron të ulet këmbëkryq
Në Pemën e Dijës
Të shohë si u prish paqja biblike, kur u dogj Edeni.

EVA IME

Unë soditësi i qiellit,
Që zgjohem me metaforat e lagura
Shtratit të ujitur...që zgjohem
Ashtu si zgjohet mëngjesi mbi det
E si zgjohen dashnorët pas një nate plot dashuri.

Unë soditësi i zogjve
Dhe i tokës...ah, i tokës së plasaritur.

Ah, ti Eva ime,
Ke rënë në gjumë t' mistershëm
Lehtësisht përkëdhel kohët
Dhe i mbyll në kopshtin tënd
Dhe ashtu turbullueshëm
Ruan fshehtësinë e përjetshme
Të gjarprit
Të mollës
Të lakuriqësisë.

S'më pyet për hutinë time
As për soditjet e mia
As për lundrimin e imagjinatës sime
Nëpër Kopshtin tënd
Ku shijen e hidhur e ndjej
Te Pema e Dijes, Eva ime
Te Pema e së Mirës, Eva ime
Te Pema e Dhembjes, Eva ime
Te Pema e Mashtrimit, Eva ime.
Te Pema pa Fruta, Eva ime
Sot e përgjithmonë,
Mbeta lakuriq para teje, Eva ime.
Me syrin mbi atë mollë...

FRUTAT E AMSHUARA

Bukuria është lart, mes tokës e qiellit
unë dhe ti.

Truni me ide të ngatërruara,
Është si malli i madh për t' vërteta t' rralla
Që fshihen n'barin e dendur, n' barin e lagur.

Bukuria është lart, mes tokës e qiellit
unë dhe ti.

Ku bien t 'vërtetat,
Si bien lisat e gjatë nga stuhia

Kështu humbet shtegu nga terri dhe s' shihen portat
E qytetit të shenjtë.

Koha s'lejoka të zbulohet fytyra e vërtetë
Në kopshtin e madh, ku mbillen të gjitha frutat, të gjitha lulet,
Edhe dhembjet bashkë me dashuritë.

E meriton lumturinë
Po, mrekullinë e lumturisë.

Hijerëndë është shikimi yt,
E sytë e tu janë shndërruar në përrenj t' tharë.

Bukuria është lart, mes tokës e qiellit
unë dhe ti.

Fjalët e tua marrin arratinë si shigjeta që largohet nga harku drejt
cakut të panjohur.

Oh sa i murmë është dheu, e pemët kanë thithur ngjyrën e tokës
E ti e heshtur thua veç lumturia është pemë me fruta t'amshuara
N' kopshtin ku bari i dendur na i fsheh thembrat tona.

ËNDRRA MË E BUKUR

Ti i ke ëndrrat e bukura
Që shtrihen si thellësia e detit
E si gjerësia e maleve.

Ti ke ëndrrat më t' bukura
Që s'i sheh askush, veç syve të etur.

Oh, ti ke ëndrrat më të bukura,
E ato të përkasin vetëm ty.

Ti ke ëndrrat më të pamundshme.

O Zot, ç' ëndrra ke ti?
Të prekësh qiellin dhe të zbresësh në fundin e tokës
Kështu të lidhësh paqen e shkëputur mes tyre.

S'ka ëndrra më të bukura se ëndrrat e pamundshme,
Thua ti, e lodhur nga zhurma dhe vramendja
Vetëm ato janë ëndrra.
Të kapërdijnë si valë deti e të hedhin brigjeve ku do e ku s'do
Aty ku syri s'i sheh kufijtë e kohës dhe shtegton si zog lajmëtar.

Ku janë pasionet e qiellit, që derdhen si shi në tokën e etur.
Teksa unë dehem në trupin tënd që i ka ëndrrat më të bukura
Si ngushëllim i përhershëm.

MURI I MENDIMEVE

Muri i mendimeve i fortë
Para syve t' zbehtë.
Ai është i madh, siç është madhësia
Ai është i zyrtë, siç është zyrtësia
Ai është i heshtur, siç është trishtimi.

Unë ndalem dhe kundroj qiellin
Aty ku tingulli im s'gjen rrugë.

Mes vakuumit të kohës dhe ëndrrës
Nuk është vendi për qetësi
As koha për pyetje, lutje, klithma
Është një tunel dhe një shandan drite i fikur.

Era luhet mendimet, luhet shikimin tim
Edhe trupin tim...
Para rri muri i fortë, i heshtur si heshtja ime
Si mendimet e mia t'varura qafës tënde.

E me syrin e majtë nuhas një të çarë
Më kaplon dëshira
Të futem në universin e pafundësive
Aty ku sfiliten dilemat e pafundme

Dhe ku tundimet s'përballohen,
Ku loja e fjalës është e barabartë me lojën e jetës
Nëpër pyetje e dilema pa fund
Nëpër klithma e rënkime pa fund
Mes kënaqësisë dhe dëshpërimit pa fund
Pyes dhe pyet:
Ku është dritarja ime?
Ngushtohet ajo, ngustohem unë
Ngushtohesh edhe ti,
Muri rritet, e ne zvogëlohem
Duke vështruar botën brenda orbitës.

Kohë pyetjesh, e përgjigjet
Janë të rezervuara si shujtë ushqimi për nesër.
Gjumë i rëndë,
Iki unë, ik ti, ikim ne.
Dhe nesër
Përgjigjet kthehen në shigjeta dhimbjesh.
Ndërsa ti, e hutuar si asnjëherë klith,
Ç'ndodh me murin...!?

SHTEGTARI

I mbledhur kruspull,
Si guaskë e qitur baltës së zezë,
Bredh n' kërkim të kohës,
Të cilën s'e njeh askush, as ai.

I përhumbur, me mitin e rikthimit që i vlon n' kokë,
Përshkon botën rreth e qark,
S'është Odise, s' ka Itakë që e kërkon.
As Penelopa s'e pret e epshme n'shtrat.

Çdo mugëtire, kur qetësia e kafshon,
Ai i patrembur me kokën e mbushur pasione
Bredh rrugëve të zbrazëta, ku jehon çdo tingull i tij.

Me grushtet përplot kujtime që i vlojnë si ujë n'zjarr
Bredh meridianëve t' rruzullimit
Pa harta e kufij, pa emër e kohë.

Si zog lajmëtar, shtegtari
Rrapëllin nëpër kohë, lexon e rilexon.
E mashtron veten pafundësisht
Duke i numëruar shekujt nëpër gishtërinj.
Pastaj kalon detin e kuq n' këmbë.

Atje s' është më Nazareti, as Toka e Premtuar.
Trishtohet. Është një kala e mbushur me mite vdekëtare.
I zhgënjyer,
Kthehet vrap nëpër detin e ngrirë
Numëron edhe njëherë vitet e jetës
Në ëndërr asnjë engjëll s'i lajmërohet.
Është i vonuar.
Kthimi në atdheun e pasioneve është më i largët
Se kujtimi për ditën e nisjes në shtegtimin e pafund!

Mugëtira ik, ik edhe koha,
Ai ec vrap duke ndjekur yllin e rikthimit,
I cili shuhet bashkë me yllin që e mbulojnë re t' zeza.
Dhe zbulimin e ëndrrës që kundërmon keq
Shtegtari, një korb i kohës,
Që vajton pa pushim në kërkim të vetvetes.

Si vjeshta përkundet para gjumit dimëror.

KALI I KOBSHËM

Para shikimit tim ishte koha ime,
Atëherë kur isha këtu, atëbotë kur s' isha atje
Në Luftën e Trojës,
Në Barkun e Kalit pa ëndrra.
Ku përkunda ëndrrat e kobshme
Për humbjen e Itakës
Për kthimin e Itakës
Për djegien e Itakës.

E pashë Helenën dhe kalimin përtej murit
E pashë... e mbuluar me një pëlhurë t' tejudkshme
Prapa së cilës shndrisnin si yje
Bukuritë e saj fatale, për Akilin
Dhe poetët e panumërt, që çirren
Me vargjet e afshme, kohë e pa kohë
Dita e të cilëve asnjëherë s'përfundon
Në njëzetekatërorëshin magjik
Duke sajuar çudira të gjithfarshme
Dhe rrugën për t'u kthyer në atdheun e pasioneve
Nga frika e Kalit t'kobshëm.
E pashë Helenën në çastet më t'ëmblla,
Pas së cilës fshihej ankthshëm
Një trup i epushëm për dashuri

Dhe një mal enigmash kurrë të zbuluara.

Dhe pra, asnjëherë s' e ndrydha dëshirën,
Të eci bashkë me erën kohëve të akullta
Dhe të mësoj lumenjtë e gënjeshtrove
Që na tretën shpirtin.
Rrugëve tona pa emra. Pa Helena!
Të topitur nga ikja prej legjendave.
Dhe sajimi i kuajve t' kobshëm, mbrëmje e mëngjes
Që hungërijnë pandërprerë mbi kokat tona plot tundime.

I mbyllur në egon prej betoni
Kundruall hiçit e tund shikimin
Duke ngrënë fiq të tharë.
Dhe një gotë verë t' vjetër sa poezia.

Përtej Itakës e shoh hijen e kalit në drejtim të shtratit të djegur të Helenës.

QYTETËRIMI I DASHURISË

I.

S'di çka di, as çka s'di.

Dje era m'i mori kujtimet e rënda dhe i strehoi

Gjoksit tonë plot ambëlsi. Pastaj aty pranë

Ra një korb, një korb i zi

Dhe u zhduk në grumbullin e gjetheve t'vjeshtës

Që kishin vrarë bukuritë;

Bukuritë e pranverës së ëmbël

Në stinën e jetës

Në stinën e këngës

Kur u bë stinë e dhimbjeve

E klithmave.

Mes lumit të shterrur

Harresa,

Oh, harresa është më e trishtë;

Më e trishtë se kalbja e bukurive pranverore

II.

I ëmbël është shikimi yt mes zemërimit

I ëmbël si ëmbëlsia e gjoksit tënd

Që mban qytetërimin e kujtesës

Të rënduar e me rrudha,

ballit t' kohës...
aty ku bie perdja e trishtimit
si nëpër skena teatrore.
Ti rëndohesh,
ashtu si rëndohen gjethet,
gjethet e njoma
kur bie borë e rëndë
para një stuhie pranverore
që i plandos përtokë
edhe blerimet më të forta,
aty ku tretet shenjat e kujtesës së jetës

III

Shenjat e kujtesës sonë
Janë shuar përballë
Murit që rri dhimbshëm.
Në zanafillën e fjalës
I thanë si Lumi i Jetës
Ishte pjellë e dashurisë.
Pastaj njëri vëlla u zgjua i trishtuar
Pa një ëndërr me gjarpër
Flinte mes tyre e bënte dashuri
E sytë i kishte stuhi.
Tjetri preferonte gjumin
Si mjet për ta shembur qytetërimin e dashurisë
E i treti,
U plandos përtokë
Përballë tymit të zi
Që e vërshoi Kopshtin e Jetës.

IV

Gjurmët e dashurisë
Janë shkelur pamëshirshëm

Ashtu si shkelin çizmet e dhimbjes
Nëpër gjurmët e rrugës së jetës.
Pastaj shkrihen lulet
Dhe pikojnë gjak
Nëpër arat e mbushura me baltë
Shkruar me shkronja të imëta
Të gjitha rrugët çojnë kah harresa
E syri yt s'i beson lajmit
As kohës që rrjedh nën ne e mbi ne
Është mësuar të kërkojë hiçin
Pranë Kështjellës së rrënuar
Është mësuar t'u besojë
Statujave të mashtrimit
E viçit të artë që pall papra.

V.

Dashuria është e dhimbshme
Është e mëshirshme,
Pasqyrë e të vërtetës së amshuar
E bën luftë të papashme me smirën
Heshtazi bën luftë me pabesitë
Me të gjitha frontet e shumta që i dalin përballë
Dhe harmonishëm bashkëndjen
Me shpresën që e mban nën sjetulla.
Dashuria nuk krenohet
Edhe kur hijet e zeza
Sulen në të
Armët i ka të përsosura
Më shumë se inatet,
Dashuria nuk vdes kurrë,
As zemërimin s'e njeh,
Dashuria.

VI

Në zanafillën e jetës
Gjarpri hyri si personazh kalimthi
Pastaj u bë epiqendër në secilën stinë.

Nuk na u nda as në pranverën e bukurive
As në vjeshtën e vdekjeve
Kur na errësohet dielli
Dhe plandoset mbi ne
Dimri i akullt
Ai e nxjerr kokën i pari
Në mëngjeset tona të njoma
Në mëngjeset tona të rënda
Na përshëndet me mollën e mashtrimit
Mbrëmbje e mëngjes
Ah, kujtesa jote si bën ballë
Tundimit për të parë
Gjurmët e harruara
Në baltën e shtratit tonë.

VII

Mes duarve të buta e mban kutinë e flidishtë
Dhe sillesh rreth kështjellës së rrënuar
Ku gjarpërinjtë bëjnë jetën e tyre
Lehtësisht marrin rrezet e diellit
Nëpër shkëmbinjtë e thepisur

Java e krijimit
Është e hëna, Im Zot
Unë zgjohem me një mal planesh
Në kokën time ku s'ka kufij.

KËNGA E KOHËS

Do të shkruaj poezi për ato që i shoh
Edhe për ato që s'i shoh.
Për damkat e kohës dhe sytë e saj të errët,
Për dashuritë e çmendura dhe ato të zakonshmet.

Do të shkruaj poezi edhe për ty
Për dashurinë tënde. Madje edhe për xhelozinë tënde
Edhe për ato që s'i njohe
Ditë e natë kur dhimbjet e tua
Pëlcastin bashkë me qiellin.

Do të shkruaj poezi edhe për klithmat e mia
Sepse asgjë s'e ndal rrugën e fjalëve
Në shtatin e vogël e shtratin e vogël
Ku thith ëmbëlsitë e kohës.

Nëpër tehun e muzikës së saj,
E çuditshme për veshin tënd, thua
Dëgjoj të panjohurat e mbledhura
Si kala kujtimesh mes zanash
Që përbirohen në veshët e tu.

E mua më zgjojnë dilemat e puthjes me yje,

Ashtu siç zgjohet lulja nga rrezet e diellit
Si zgjohen kujtimet në rrethin e fildishtë
Ku bluajnë minjtë grabitqarë
E gjuajnë tingullin tënd
Tingullin e këngës që thua është për ty
Për kohën që ec mbi ne si re nordike
Ku luhet keq me sytë e kohës
Me sytë e pafundësive
Ku thuren kunora për dëfrimin tënd
Për dështimin tënd.

*

Asgjë s' ndodh...
Gota e rakisë pret shikimin tim
Dorën e lodhur që kërkon nëpër tymin e cigares
Shikimin që iku, shikimin që ra u plandos
Shkëlqimin që u plandos, shikimin që ra e iku
Si dora ime e lodhur në lakuriqësinë e natës
Që hungërinte me zhurmën e dhimbjeve
Në trupin e etur.
Thur aureolën e fjalëve të nxehta
Që djegin duart e mia të lodhura
Dhe me hirin e prushit që turfullon nëpër hapësirë
Rrëshqas, rrëshqas e rrëshqas si nëpër akullnajat e antarktikut
Dhe i them vetes
Asgjë nuk ndodh.
Pi një gotë raki...si i dehur rropatem me veten
Madje çuditërisht marr në thua në cungjet e kohës
Ku idetë e mia përvishen të marrin jetë
Dhe iu them zogjve:
Këngët tuaja s'po dëgjojen
Ka shumë zhurmë, zhurmë ka shumë.
Ik nata, ik edhe shikimi yt
Edhe gota e rakisë nxehet në dorën time.
Nata s'e prish misterin e saj

As zogjtë nuk dëgjoen
Ka shumë zhurmë, zhurmë ka shumë
Më thua habitshëm
Dhe kam dorën tënde
Dhe kam krahët e mi
Që u plandosën
Nëpër cungjet e kohës
Dhe idetë që avullojnë
Teksa gota e rakisë
Pëlçet mes duarve të mia
Ku fluturon zemërimi
Për kohën e pështjelluar keq
Në natën kur zogjtë nuk këndojnë
Në natën kur zogjtë nuk dëgjoen
Në natën kur ka shumë zhurmë.

TUNELI I SABATOS

Ti ike përjetësisht matanë tunelit.
Pa pyetur t'u hapen dyert e rënda,
E ne përtyrim fjalët si kafshatën e tharë
E me gjysmëfrymëmarrje sajojmë idetë e botës
Duke u përpjekur të lëkundim pikëpyetjen tënde
Pse s'e ndriçojmë terrin e zi?

Tunel dje
Tunel sot
Tunel nesër.

*

Na rrëshqasin këmbët keq n' pragun e tij
E të trullosur hyjmë brenda
E kthimin se gjejmë nëpër kryqëzimet e rrugëve
Pa shenja shpjeguese,
Rrugëve të errëta me heronj e varreza,
Pa emra
Pa drita.
Shenjat e jetës s'i shohim
Në pragun e tunelit tënd
Kalojmë symbyllazi

Dhe marrim në thua -
Eh, çuditërisht s'e shohim qiriun
Se na tërheq terri.
Pastaj, si kuaj në maratona t'pafund
Marshojmë me memorien e rënduar
Pa kuptuar se një shkëndijë e vogël
E mund terrin e madh
Të tunelit tënd, të tunelit tonë.

*

Testamenti yt i pashkruar na shoqëron
Si qiri në prag të tunelit
Na qorton brutalisht
Çdo ditë na thotë:
Një dritëz e vogël e prish harmoninë e territ të madh.
S'shohim Ernesto
S'kemi sy dhe s'e gjejmë dot
Kemi harruar shumë, madje-
Kemi harruar se rruga për të kaluar përtej tij është e pamundshme
Pa një shkëndijë nëpër duart e dridhura
S'e ruajmë as drejtpeshimin.
As sytë e stuhisë
S'na bëjë punë
Në turbulencën e së zezës
S' çahet tuneli...bërtet një zë
Rrëmbyeshëm hyjmë;
Hyjmë duke harruar qiriun e vogël
Që prish terrin e madh.
Ashtu heshtazi na i thith sytë terri, o
Terri i tunelit të pafund
E dora na dridhet si ajo e piktorit
Që s'arrin të kapë një dritë të vogël
Në terrin e madh...
Para trupit të asaj që e do e s'e do
Para asaj që e do dhe e vret.

*

Dhoma e pritjes
Drama e pritjes
Më e errët
Se tuneli yt
Dhe heronjtë e rremë
Që çirren pa pra
Që çirren pa ndalur.
Mosbesimi s'është normë e duhur
T'i duash apo të mos i duash dhimbjet
Ta refuzosh a ta pranosh dashurinë
Në qytetërimin e jetës
Nëpër tunelin e kujtesës
Nëpër tunelin e shpresës
Nëpër tunelin e pendesës
Dashuria jote është
E heshtur
E fjetur
E tretur
E nemitur
Si trupi i J. P. Casteles
Që klith, klith papra.
Dhe trembet nga qiriu në tunelin e dhimbjes
Që trembet nga qiriu dhe sheh vetëm terr
Terrin që ia thith sytë.
E ti,
Nëpërmjet tij
E rrëfen çmendinë
Dhe tredh mendimet e kohës
Ashtu si tredhet koha e sajuar
Ku dashuria e urrejtja s'ndahen me kufij.

*

Unë s'bëj dialog me ty
Nuk bëj dialog as me kohën
Të cilën e ke kapur në duart e vogla
Ti, ballit të djersitur ke vënë shkronjat e saj
Tuneli yt është tuneli im
Pështjellim-klith ti,
Pështjellim-klithi unë.
Nuk flasim më.
Fjalët tona i ka përpirë tastatura e kompjuterit
Në dy skaje rrimë të hutuar
Dhe flasim pa fjalë për tunelin e pafund.

TRAZIMET

Muzgu bie mbi sytë e tu, ti zgjohesh e dehur
Si bora e parë mbi malet e jetës.
Pastaj çirresh pa u ndalë për dhimbjet që nuk t'i kupton kush.
Është mëngjes si zakonisht
Dielli merr shtegtimin e ri.
Ti e fillon ditën nëpër duhmën e espressos
Dhe tufës së gazetave ku gulçon trishtimi i ditës së djeshme
Bashkë me shujtën e rrenave për ditën e sotme.

Askush s'çan kokën-thua dhe fshin ballin me dhimbje.
Rrugët tona kanë lule, gjemba kanë;
Rrugët tona kanë gjemba dhe lule kanë.
Si zakonisht përdridhet shikimi im në hapësirë
E mes xhepave plot trazime
Mbaj duart e zjarrta
Dhe ca fjalë që avullojnë
Dhe ca ide që avullojnë
Dhe ca dhembje që avullojnë.

Është mëngjes, si zakonisht
Askush s'merret me retë që përhapen shpejt,
Askush s'merret me diellin që zhduket shpejt,
Askush s'merret me ëndrrat që shuhen shpejt,

Askush s'merret me ty dhe kohën që s'e sheh.

Pikojnë lulet, aroma e tyre ngjitet trupit tënd
E shikime të mrrolura e shikime të venitura
E shikime të venitura e sy të mrrolur,
Pikojnë si vesa e mëngjesit
Mes avullit që thith shikimin tënd
Mes avullit që zbeh shikimin tënd.

Është mëngjes e rruga shkëlqen
Aty ka kohë të vjetra e shikime të reja
E aty ka kohë të reja dhe shikime të vjetra.
Madje ka kohë të kalbura, e shikime të reja.

Dhe sot, i kap për fyti gjithë ato kafka që gëlltisin
Gjithë ato kafka që nuhasin
Çuditërisht me gjuhën e dhembjeve,
me gjuhën e heshtjes
me gjuhën e revoltës
me gjuhën e pritjes.

Një mal zemërimi
Dhe shkruaj dhembjet e Ferrit
Dhe shkruaj trishtimin e daljes në Purgator
Dhe shkruaj lumturinë e Parrizit,
Dhe shkruaj.
Zoti im
Metaforat kanë ndërruar trajta,
Ngjyra
Sot e përgjithmonë.

QYTETI I AKULLT

Puplat e zogjve bien përtokë
E një grua ec ngadalë mbi to
Si nëpër gjëra të çmueshme.

Bën ftohtë, si asnjëherë, Zoti im
Pranvera vjen me rënkime dimri
Dhe kujtesën e ftohtë që treti lulet, pemët,
Gjurmët, ato imazhet që i përpiu dheu.

Veç një mbishkrim lexohet:
“Kundër nesh flasin të këqijat tona”

Kështu u ngrinë edhe ëndrrat e bukura
Si shtiza akulli t’varura nën çatinë time.

Unë zgjohem me agimet e mjegullta
Dhe shoh akullin si rritet.

Aty është shtegu prej ku nis rrëfimi i pakryer për Kalin e Trojës
Që hungërin ditëve të akullta
Kur pëlçet trishtimi
Në ditët kur dergjet kujtesa
Si dergjet i sëmuri në shtrat.

Ajo ec shkallëve të trishtimit
Rrugët e caktuara ende s'i ka mësuar
Dhe pret
Në kështjellën e ëndrrave për të kuptuar fshehtësinë e pranverës

Një hap larg Itakës
Rrënjët e pemës
Nuk shihen
Zoti Im
Për fruta nuk ka kohë të mendohet
Është kohë e akullit.

IDENTITETI

Nëpër pasqyra shumëngjyrëshe s'shihet asgjë,

As gjurmë

As hija e lajmëtarit të dritës

Me kandilin që lufton errësirën.

Lakuriq shfaqen vetëm statujat e përlotura të qytetit X,

Ku gjëmojnë të përbuzurit që pyesin për paqen humbur.

E në dritare rrinë gra lakuriqe. Ato kanë shartuar pemët dhe presin kalorësit e dhimbjes. Presin kthimin.

Në dritaren e vogël rri ti, me sytë e bukur e flokët e shprishura.

Ke veshë një fustan të papërshtatshëm për trupin tënd t'bukur.

Me vramendje thua librat i lexojmë me u pështjellë me idetë e tjerëve,

Idetë e tjerëve i përtypim si përtypet fjalët para se m'u shkëputë nga qenia,

kur marrin arratinë e panjohur si shigjeta e shkëputur nga harku.

Ky është hidhërimi i të mos qenit vetvetja.

Lakuriqe shfaqen vetëm statujat e përlotura të qytetit X

ku dashuria s'ka tinguj përcjellës,

e truri s'ka vend për risi, s'ka vend as për dashuri-

truri që racionin e ka të përcaktuar

nga kujdestarë...ato rojet e injorancës, rojet e territ

që dritën e luftojnë tash e mot.

Rritemi duke u mësuar se si të dashurojmë
e dashurojmë duke mësuar ma parë urrejtjen.
Kjo metamorfozë e jetës ka zanafillën te orgjitë e tempujve mash-
trues,
ku lakuriq shfaqen vetëm statujat e përlotura-
thua me një dhimbje që s'e shpjegon me fjalë,
kjo metamorfozë e ka zanafillën te gjarpri mashtrues-
them, me një dhimbje që se mbuloj me fjalë
Luajmë me fjalë, luajmë me ide
dhe i tundim dilemat e mëdha,
si andrrën tonë për Parajsën e humbur.
Dhe përplasjen në përqaqim e pemës së shartuar, pa identitet.
Ku i hëngrëm frytet pa shije.

ÇETA E ENGJËJVE

Marramendja shtrihet gjerë e gjatë
Në ditën kur agonia ec mbi mua e mbi ty
dhe kthen kokën mbrapa.
Aty janë hapat e mëdhenj, ku idetë e tua marrin n'thua,
Ashtu si merr në thua ti, në një ditë me mjegull,
Kur trutë të hallakaten nga era dhe kërkon ta puthësh qiellin.

I shoh sytë e mërzitur, si lulen e venitur
T'vizatuara nëpër shkruabin e pikëllimit
Si kujtimi për kulturën që s'është më.

Vjeshtë e vonë, oh ç 'vjeshtë e frikshme,
Si vjeshta e humbjeve, me bukuri t'venitura, me bukuri t' kalbura.

Marramendja shtrihet gjerë e gjatë
Në kohën që ushton pa pra
Para nesh e pas nesh,
Labirintet e së cilës janë të frikshme,
Si rruga drejt Ferrit,
aty ky dëgjohen klithmat e çetës së engjëjve
Si drithërimat e zogjve pa fole.
Dhe vargjet e habitshme:
"Populli im, çfarë të keqe të bana
E çfarë trishtimi të solla"?

Qëmoti një kambanë në qafë të poetit
Tingëllon për gjërat e paarritshme
Ashtu si shtegtimi i Dantes nëpër rrathët e Komedisë
Pa poetin udhërrëfyes.

KRIJIMI I DASHURISË

Është vendi ku gjuha e Abelit triumfon
Ku lulet flasin me tinguj dashurie
Ku përkthimet janë të panevojshme
Ku lidhjet e ndjenjave bëhen pa lajthitje.

Si nëpër ujëra të turbullt,
Aty lundron e pamposhtur Arka e Shpëtimit

Aty shpartallohen mendimet e egra
Si pushtohet njeriu nga dashuria
Në atdheun e përjetshëm
Ku paqja biblike shfaqet si n' Eden.

NËPËR SHKRETËTIRË

Shtegtari i shkretëtirës,
Ushqen iluzionin se pas kalimit
Njom buzët e thara në gurrën e jetës
Vetëm kështu lëviz këmbët e molepsura

Ato këmbë elastike që janë mësuar me therra,
E krimba t' kalbur;
Gjarprinj mashtrues që u ushqyen me molla
Plot helm.

Jo, nuk është etja, është dhembja ime ditëve t'perënduara.
Para liqenit të shuarjes këmbët e mia të lodhura s'mbajnë
Barkën e jetë së tronditur nga dhembjet dhe nostalgjitë e marra
Pas - gjurmët janë të këqija dhe gjarprinjtë helmues
Që ecin rrugëve tona ditë e natë na dhunuan.

Çdo bimë që s'jep fryte, është hije e tokës!

NË QYTETIN MJEGULLËS

N' qytetin e mjegullës çdo gjë është ndryshe
Mendimet janë ngujuar si mashtrimi ynë nëpër statuja.

Aty lulet bëjnë jetë mes therrash,
E brenda tyre vallëzojnë lirshëm vetëm insektet
Zoti im,
Qyteti i mjegullës rrugët i ka të ngushta,
Edhe mendimet i ka të ngushta
E kënga Aleluja s'dëgjohet askund.

Aty plehurat s'kanë vend,
Nëpër këmbët e lodhura janë pështjellë.
Veç fjala përpiqet ta mbrojë dinjitetin e shkërdhyer.

Merimangat kanë lëshuar shtat
Ku mbeturinat e mendjes janë bërë cungje nate,
cungje kohe.
Që thyejnë dhëmbët e prishur nga ecja e paqëllim
Që thyejnë gjunjët e rënduar nga mëkatet e rënda.

Në qytetin e mjegullës dritat e kinemave janë shuar
E ekspozitat bëhen nën trysninë e qirinjeve që luftojnë me errësirën
Poezia lexohet skajeve të pikëllimit

Ku vetëm qentë e zgjebosur shëtisin t'qetë
Aty ku era e politikës ka qelbë çdo gjë;
Cicërimën e zogjve e puthjet e dashnorëve.

Në qytetin e mjegullës, plehrat kanë mbuluar lulet
E n'mes është pellgu i padijes
Ku liria dhe lufta s'kanë kufij
Ku poezia dhe jopoezia s' kanë kufij

Aty shtegtojnë mendimet si nëpër xhepa me bërlllok.

Aty ku grabiten dhimbjet e shumta
Që sillen nëpër qiell dhe bëhen ushqim për barkun e politikës.

Aty prej kohësh ka zënë fill numërimi mbrapsht
Prej ç'kohe ashtu zuri fill numërimi shtrembër.
Aty ndjehet mungesa e "Qytetit të Zotit"

ARTISTI NË KOHËN TEKNIKE

Rrugëve të shpresës i kërkon iluzionet,
ashtu si kërkon ai që humb gjënë e çmuar
me sytë e zgurdulluar.

Me duart e rrudhura e shikimin e lodhur,
i fërkon metaforat dhe del rrugëve plot zhurmë,
ku qetësia është plagosë.

Ai ec si endacak rrugëve t'njohura
Zëri s'i dëgjohet, ka shumë zhurmë.

Me armët e vetme, fjalët si mburojë
shtegton mespërmes turmës.

Është ftohtë, errët, bie edhe shi.
Ai ec, e fërfëllima e erës ia shprish flokët e harlisura
Sikur vargjet e ndotura nëpër xhepa
Ku ruan plehra e shumë pelim.

Aty bërtasin ithtarët e shëmtisë, promovuesit e zhurmës;
bashkë me sirenat e politikanëve që kanë zëvendësuar tingujt e
zogjve

dhe deklaratat politike që lexohen n'vend të poezive.

Ai ec me shikimin e humbur dhe thotë:

Popull spektator, je në teatrin e jetës

Loja luhet, që ti t'mos kuptosh asgjë:

këto janë urdhërime për ty:

Brohorit kur të kërkohet dhe pjesën tjetër, fli qetë.

Mbi të sorrat kanë bërë kordon dhe glacojnë kokat e kalimtarëve.

Me sy t' mërzitshëm pi espresson që i avullon mes duarve t'ftohta,

Mbi tavolinë i sorollaten fytyrat e mbretërisë së anomalisë.

pi espresson dhe shfleton gazetatat. Kulturë s'ka

Veç janë disa silueta të ideve të tredhura për kulturë

Dhe portrete të shumta politikanësh.

Rrugët janë të zhurmshme. Atij i shfaqen tempujt e mashtrimit.

I vetmuar bredh rrugëve të kohës

Rrëzohet e çohet si lule në stuhi.

Çdo mëngjes i pyet zogjtë për pikëllimin e tij.

Një artist i vetmuar, nën sqetulla mban libra

dhe s' pranon të hyjë nën sqetullat e marrëzisë.

LOJA E KUJTESËS

Pasqyra rri e ftohtë si akull Antarktiku
Përballë syve që e shikojnë habitshëm,
Aty është pika e zjarrtë, si vendi
ku u lidh Prometheu dhe nyja e dilemave
që bluajnë mendjen njerëzore.

Si në skenë teatri, ulesh dhe ushtron dramën e harrimit.
Pas çdo përsëritjeje ndjen një shtrëngim në fyt,
Aty s'është Zeusi, askush s' bërtet nga hidhërimi
As shkëmbinj që të t'lidhin për ta.

Ti ec një hap para e dy prapa, me trupin elastik
Para regjisorit që fishkëllen përtej mureve të teatrit.
Ti s'e njuh, ai s'të njuh,
Veç dëgjon instruksione si shuhet kujtimet, si tjetërsohet kujtesa.

Veshët e tu janë lodhur, shumë t'lodhur.
Dëgjojnë shushurimë fjalësh, dëgjojnë klithma fjalësh
Dhe britmat e njeriut që lufton për t'u çliruar nga vargonjtë e dhembjeve, vargonjtë robërisë.
Skena është e zbrazët dhe ushton
Si ushton zëri i shtegtarit në pyllin e pafund të mistereve

Pastaj diçka ndodh brenda teje:
Të trazohen ëndrrat, si fantazitë e fëmijëve.
Unë s'flas. Nuk guxoj as t'hesht
Ti dridhesh në skenën e zbrazët teksa ushtron dramën e harrimit
Duke ecur një hap para e dy prapa.

Lëvizjet tua janë të ngadalshme,
Në heshtjen që kumbon sheh dy sy
Si fantazma e Hamletit.
Rrudhesh, tkurrësh dhe ha imazhin tënd.
Aty pushon shikimi i zbehtë në dritën e së cilës kërkon hapin e fundit.

Skena është e frikshme, ashtu si drama jote. S'dëgjohet asnjë zë,
Teksa ti bën përpjekje ta tjetërsosh kujtesën.

Ajo tërbohet, ashtu si tërbohet deti,
Dhe pamëshirshëm përplas sytë e mëdhenj t' kohës
Misteret e thellësive që i hedh në brigje.

Koha ka nxjerrë sytë e ciklopit
Që vallëzojnë në duart e tua plot zjarr.

Ti shtrëngon fytyrën.
Sheh veten si në pasqyrën që t'i shfaq të vërtetat,
Rrudhat në ballin tënd, sytë e tretur
Qepallat që mbulojnë dhembjen,
Flokët e shprishura dhe buzët e holla,
Dhe gishtat që dridhen duke i përzgjedhur dëshirat,
përballë jehonës së kujtesës!

SKENË E ZBRAZËT

Është natë. Skena është e ftohtë.

Ti vazhdon lojën e pakuptimtë

Në skenën e zbrazët mes regjisorëve të panjohur.

Lyp duart e dashura për të shtrënguar mungesën tënde

Lyp buzët e zjarra për ta shuar mallin tënd

Teksa përplasesh nëpër shkallët e teatrit.

Duke luajtur dramën e kujtesës, shtron pyetje:

si niset e kaluara dhe merr jetë në t' sotmen

si zogjtë harrojnë këngën dhe shtegtojnë pa destinim

si kënga tjetërsohet në dhimbje dhe trazon qetësinë

si poezia bëhet e mërzitshme dhe ti lexon politikë

si romanet shkruhen për gjëra që s'duhet dhe ti lexon histori.

kjo është kohë klithmash për kohën që ta ka rënduar qafën

si rëndohen malet nga dëbora

dhe fshehin brenda ndyrësi.

ATO QË NUK ARRIJMË

Hëna skuqet, era tërbohet, ashtu si buzëqeshja jote.
Çfarë mbeti pa u shkruar, pa u thënë
Për një çast ulem e kundroj qiellin
Dhe shtrëngoj duart e mia n'qafën tënde
Dhe rri në një largësi kokëfortë,
Ku duken plasaritjet e qiellit
Dhe shihen vrimat e tokës së zezë.

Në prapaskenë shtrihet heshtja e gjatë, e zymtë
Si dora e Pandorës në arkën e sekreteve
Si nëpër mjegull i shtrij duart përpara
E përgjigjet për ato që kërkoj, s'i gjej.
Jo... s'i gjen as ti.

Përplasje. Angështi. Fjala çan natën e zezë,
Në të cilën zhvendosen të vërtetat si fletët nëpër erë
Dhe fluturojnë në lartësinë e qiellit ku vetëm zogjtë jetojnë të lirë.

Hëna vazhdon skuqjen, era vazhdon tërbimin,
Buzëqeshja jote zvetënimin,
Dhe thua: lutjet s'dimë kujt t'ia drejtojmë.

Është natë, hëna skuqet.

Kujtesa jonë është një thes i madh
Ku dëshirat përzihen si fjalët pa kuptim
Dhe përplasen ëndrrat me realitetin si në një skenë mundjeje,
Në vrullin e rrëmbyeshëm, shpërlahet koha
Si ti n' ujëvarën e dashurisë.

Unë s' lëviz, vetëm shikoj
Duart e mia imune nëpër mbeturina
Si lypin ëndrrat e patreguara, në rrënojat e qytetërimit të hershëm.
Muret e të cilit thyhen çdo ditë nga hapat e pakontrolluar.
Qëndroj i heshtur, i heshtur si di t' jetë vetëm heshtja,
Pastaj mblidhem, tkurrem e ngushtohem brenda heshtjes sime.

Jashtë hëna vazhdon skuqjen, era tërbimin
Ashtu si buzëqeshja jote harenë e zvetnuar
E ti nëpër kthinat e vetmisë, pret ta vrasësh kujtesën
Dhe të zbresësh shkallëve të saj t' zbehta,
Ku sytë e rëndomtë s' shohin gjë,
Për t'i lexuar rreshtat e pashkruar,
Ku shfletohet libri i mistereve,
Mes diferencave të dhembjes e gëzimit.
Shoh qiriun që mund terrin.

ZANI I KOHËS

Si hija të ndjek misteri i pakuptueshëm
Klith i hutuar, kam ndjekës
Ik i hutuar e bërtet, kam ndjekës
Të dridhet turpi i ëmbël
Dhe përpëlitesh, kam ndjekës.

Pastaj para një lisi të gjatë
ndalesh dhe shikon qiellin e gëzuar
Është blu, shiu ka pushuar, edhe retë janë zhdukur.
Atje sheh sytë e dritës, si lajmëtari cakun.

Ndalesh, merr frymë,

Zogjtë lëshojnë tingujt t'ëmbël,
Ashtu si tingujt e shushurimës së pemës
Dhe pastaj sheh një re të vogël në qiellin e pafund.
Merr rrugën te neurologu
Ai çan kokën, me librat e trashë nëpër duart e rrudhura,
Lyp dhembjet tua, o Zot lyp misteret tua
Me syzet e mëdha, e gishtat e dridhur
Endet nëpër tavolinën e tij.

Ti dridhesh. Më ndjek pas?
Klith dhe sillesh nëpër dhomën e mbyllur.
Hutohet neurologu, trishtohesh ti.

Ndërgjegjja, ç'kështjellë e pamposhtur.

LARTËSIMI

Është turbulluar qielli
Pylli dridhet nga rrufetë
Pastaj vjen shiu dhe stuhitë që rrëzojnë lisat.
Ujqit struken nëpër shpella
Gjarpërinjtë humbin forcën lëvizëse.

Arka e Noes nuk është aty
As Ylli i shpëtimit.
Gjirafat ulin kokën.

Ti dridhesh
Streha jote është koha e djeshme
Dhe kujtimet e saj,
Që bien si gjethet e blerta
Në një mot të keq vjeshte,
Ku nuk e sheh veten dhe fytyrën tënde
As arkën e shpëtimit.

KOPSHTI I EDENIT

Në perëndim të diellit është një kopsht i bukur,
Brenda i ka të gjitha ngjyrat
I ka gjitha pemët, e gjitha lulet.
Ai i ka edhe frutat;
Ka edhe lumin që gjarpëron mes tij.
E lumi s' ka urë,
në vend të saj, është pema e dijes,
N'maje t'cilës pingul rri koka e gjarprit me lëkurë njeriu
Dhe një grua e hijshme.

Atë e përkëdhelin fletët e pemëve n' lëkurën e saj të butë
Në vend të dorës së një burri
Që ka ngulitur shikimin n' majën e Mollës së Ndaluar.
Prej ku u shumua e keqja.

FOLEJA E DASHURISË

Si nëpër ujërat e turbullta,
aty lundron e pamposhtur Arka e Shpëtimit.

Është vendi ku gjuha e Abelit triumfon,
ku lulet flasin me tinguj dashurie,
ku përkthimet janë të panevojshme,
ku lidhjet e ndjenjave bahen pa lajthitje.

Aty ku shpartallohen mendimet e egra
si pushtohet njeriu nga nevoja m'u vetplotësue
në atdheun e përjetshëm
ku paqja biblike shfaqet si n' Eden.

DRAMA E DASHURISË

Ditën e parë t'pashë nëpërmjet xhamit,
E lagur, e përhumbur n' kotësinë e kohës.
Dora t'dridhej nëpër flokë pavetëdijshtëm
si shikimi yt që lëvizte pakuptim.

Pastaj pashë shikimin e hutuar si i kërkonte pikat e lëvizshme në
horizont. Dhe ngadalë të putha afshëm duke provuar udhëtimin e
pa fund

Me një mal dëshirash që vallëzonin papra
Shkrova fjalë të pakuptimta në avullin e kohës,
si vizatimet e duarve tua në xhamin e ftohtë
Aty ku ishte dritarja e pritjes e palexueshme për sytë e kohës.
Për sytë e mi-pëshpërite ti, për avullin e xhamit-thashë unë.

Dhe ashtu guximshëm refuzova të kalkuloj pyetjet e përgjigjet
Të cilat i hedha fuqishëm në koshin e kotësisë
U zgjova i djersitur, me një eksitim t'paparë
Dhe nisa ditën e re duke e ledhatuar kohën që fluturon me retë e
pranverës, bashkë me nudizmin tënd të mrekullueshëm.
E unë si vjelës rrushi, zbrisja trupit tënd,
Atyre shkallëve t' panjohura,
Pastaj ia thashë këngës në trajtat më të bukura
Duke dëshiruar mospërfundimin e ëndrrës.
U zgjova dhe pashë se ishte bërë dita e tretë.

I sodisja yjet si vallëzonin mbi ne
Tek merrja frymë n' gjoksin tënd.
Dhe ujita ngjyrat për pikturën e së nesërmes.
Kështu pa vërejtur në ditën e katërt u përplasa
Dhe e lidha heshtjen tënde për Pemën e Dijes
Duke ulur kokën ngadalë mu n' barkun tënd
Dhe vazhdova të lexoj poezi
Derisa u bë mbrëmje e mëngjes dita e katërt.

Një yll u kap pas syve të mi kur pashë se u bë edhe dita e pestë
I lodhur nga pesë ditë ëndërimi,
vazhdova t' këndoj vargje që s'i kapte veshi yt i skuqur
veshi yt i ujitur për zëra të tjerë
Kështu u bë dita e gjashtë
Ti u veshe për herë të parë
Dhe s't'i pashë gjinjtë e ëmbël
As kofshët që bashkonin brigjet e paarritshme
Dhe u veshe me terrin e natës
Sytë m'u shndërruan n' kureshtje
Sikur të mos kisha parë kurrë...
Dhe zbrita mesit të qëllimit
Aty ku shuhet qiriu dhe nuk ka nevojë për rekuizita
Gjithsesi, u bë dita e shtatë
Rashë në gjumin e kotësisë, afshëm
Mes ëndrrës dhe hapave të mi, mata kohën nga fillimi
Në fillim e fund ishte diçka ndryshe
Veç fjala ishte e njëjta
Prej saj u bë çdo gjë e pa të s'u bë asgjë.
E mua sytë m'u mbyllën,
Ndërsa nëpër kthinat e banesës sime,
Strukeshin sytë e gëzimit

ALFABETI I DHEMBJEVE

Është muzg, terri na futet n' sy
S' shohim ku i qesim hapat,
E këmbët na ngatërrohen
Na duhet ta kalojmë këtë natë
Për ta parë agimin.

Që ta ngrehim qytetin e shpëtimit
Maja e të cilit do ta prekë qiellin.
Ku ajri është i pastër si dashuria vetë
Ku përkthimet e poezive bëhen të panevojshme
Derisa nuk digjet prapë Sodoma dhe Gomora.

A është kjo re që shëtit mbi ne paralajmërim se rrufeja mund të na
godasë?

DIALOG ME DASHURINË

Në orët e saj nis loja, e ngjashme me një maratonë pa fund.
Është vjeshtë, e pemët kanë filluar të zhvishen
Gjethet e tyre kapen për këmbët e mia
Unë vrapoj të prehem në shtatin tënd.

Pastaj stacioni i pritjes afrohet shpejt
Ku lëshoj kokën dhe hedh shikimin e përmallshëm
Mes meje dhe dashurisë ekziston libri i përjetësisë
Ku shkruaj çdo ditë lumturinë
Në trupin tënd gjithmonë të ri, ku bie e zgjohem
Çdo herë i ri
Aty ku puthen të gjitha kohët përnjëherë
Ka s'ka nevojë për fitore e disfata
E ku të gjithë flamujt kanë ngjyrën e njëjtë
E ku pirgu i Kullës së Babelit qëndron kryelartë.

RRËNOJAT E DASHURISË

Një rreze dielli përplasat mbi sytë e mrekullueshëm,
Shkreptin aty ku përkundet shikimi i butë
E kohët uturijnë me pasionin e kujtesës si në akuarium.
Ëmbëlsisht rrezja kalon nëpër trupin tënd, t'i prek gjinjtë.
Krahët e lakuriqësuar, butësisht t'i përkëdhel, e bukura ime.

Pastaj, ti e tund shikimin e butë drejt rrezes së bukur. Dhe thua:
Pafundësisht e bukur është dashuria vetëm kur është dashuri.
Dhe shëtit e etur si n' Kopshtin e Edenit, pranë lumit të qetësisë.
Me pasionin mbi supe, plot dëshira të përflakura, plot çudira.
Të ëndërruara nëpër kohët e mbledhura në grusht, thellë e më thellë.

Mbi rrënojat e dashurisë ec si baletane a flutur që prek qiellin.
Dhe e preh buzëqeshjen e ëmbël, tmerrësisht të ëmbël në yllësi.

Pa hamendësime për kohët që djegin me shikimet e vrazhda.
E kap dashurinë në dorë si një plaçkë për ty, për bukurinë tënde.
Dhe rrezet e diellit që ngrohin kockat e akullta në gjumin e dhembjes.
Puthja jote është ëmbëlsisht e ëmbël, pafundësisht e ëmbël.
E mrekullueshmja ime.

Nata vesh rrobat e zeza, ti shëndrit si yll
Pastaj rrapëllin e heshtur në ah-et e shpirtit t' trazuar.
Duke zhveshur mendimet e bllokuara nëpër zhurmën e kohës dehëse.
Tingujt e lehtë të muzikës së shpirtit që na bëjnë hije.
Hesht ti, hesht qielli, hesht edhe zhurma...teksa të brendshmet tua
Bëhen flutura nëpër dhomën e boshatisur nga mendimet.
Asgjë, asgjë e mrekullueshmja ime
Nuk vlen më shumë se trupi yt i shtrirë, që nuhat aromën e dashurisë.
Nëpër skutat më të errëta përhumbet syri im i etur, i pangopur...Oh.
I shatisur për t'u zhytur thellë në ty, e mrekullueshmja ime.

PANAIRET E POEZISË

Unë ec dhe përcjell shtegtimin e resë qiellit blu
Para shfaqen dyert e hapura, ku është panairi i kotësisë.

Një grumbull njerëzish shkojnë drejt derës së ngushtë
Si para një tempulli lutjesh.
Kur hyjnë brenda e kuptojnë rëndësinë e t'qenit jashtë.
Si dëshirën për t'u kthyer në liri.

Kambana t'panjohura vazhdojnë t'rëndojnë veshit tonë.

Aty ku ka shumë fjalë
S' dëgjohet zëri i zemrës.

Dyert hapen. Grumbulli i njerëzve mbush sallat e panairit
Të gjithë e shohin sa e vogël është dera e kthimit.

Si në një kor pa dirigjent, ata vrapojnë andej e këndej.
Unë vështroj turmën, njerëzit dhe derën e vogël
Aty pranë shoh mbishkrimet e palexueshme.
Dhe pikturën e madhe të së Premtes së Madhe.

Në pikën ku ndodhem, dua rrumbullakimin e vetes
Rrëfëhem si para priftit me zhgun të gjatë

Brenda një hapësire t'padukshme është një dritare e vogël
Ku shoh vetëm një qershi të kuqe
Dhe një grumbull qengjash që kullotin pa bari.

Mua më frushkullon kujtesa
Dhe i shfletoj ngadalë dëshirat e mbuluara me petka t' zeza
Pastaj të drejtohem ty me një rrebesh pyetjesh,
Si ecet nëpër kthinat e kujtesës sonë,
Pa shkallë për zbritje e ngritje?
Veshi ynë asnjëherë si ka mësuar këngët e kohës
As rrugën për të zbritur nëpër shkallët e kujtesës.

ORA E POEZISË

Është një grumbull njerëzish
Disa vallëzojnë para një orkestre që lufton me erën
E në një kënd të qytetit, lexohet poezi,
Poetëve u dridhen duart, e fletët ua tund era.
Brenda mureve ruhen mistere t' pashpjegueshme
Si nëpër kështjella të vjetra:
dokumente, armë, shtretër dashnorësh.

Në mes tyre je ti me hijen tënde dhe fustanin e kuq.

Unë shikoj pikën e panjohur për ty, për grumbullin e njerëzve,
Për tingujt e muzikës e metaforat e poezive.

Era vazhdon uturimën, e publiku zhurmën,
Orkestra muzikën,
Poetët lexojnë poezi me fletët që ua tund era
Nëpër dhëmbët e të cilëve metaforat marrin n' thua.

Ti injoron turmën, injoron erën.

Kur humbet arsyeja, diçka brenda shkatërrohet
Nuk dihet prej çfarë rruge vjen hidhërimi
As kah shkon...

Nuk e dimë si lind dashuria, e më pak si shuhet
E ndejmë humbjen si qiriun para fikjes
Gjithçka i ngjan një furtune
Që merr përpara të mira e të këqija
Vjen pastaj qetësia, ku çdo gjë është e përmbysur.

Atëherë kur duhet më shumë se çdo gjë sipërfaqja e së vërtetës
Bie terri i zi.

Deti është i trazuar si ti,
Si dashuria që zhvesh çdo gjë,
si arsye e ekzistencës së poezisë
dhe fjalëve që marrin jetë duke u ushqyer me emocionet e tua,
me trupin tënd,
që vlon si uji në prush.

E rëndësishme është n'kokë t'i largosh kufijtë, më thua
Sepse ashtu e kuptojmë rëndësinë e qenies
Unë s'kam fjalë, prehem në shikimin tënd t'ëmbël,
Që qetëson valët
Që lartëson fjalët, si një thirrje hyjnore
Që shpjegohet nëpër ditë me shi.
Poezia e gjen udhën e zemrës,
Nëpër udhën e mendjes
Dhe fle në shtratin ku përherë përkundet dëshira
Për ta luftuar terrin, sipërfaqen e padukshme mes të mirës e t' keqes

Në Kopshtin e fshehtësisë është një lule e fshehur
Që nuk shihet nga perdet e zeza.

YLLI

Ti e ndjek yllin dhe thua
Atje është varur shikimi yt
Si flamur i lagur n' kalanë e braktisur
Ku kanë mbetur vetëm gjurmë
Dhe rënkimet e një tingulli që s'është më

Nisesh me hapa e mëdhenj
Dhe si sheh rrënojat
Ku përplasesh me dëshirat e tua
Që shtrihen përtokë.

Qyteti rënkon,
Si rënkon ai që humb gjënë e dashur,
Njeriut që s'i dëftohet më rruga e kthimit
Në tokën e premtuar.

LIBRI I FYTYRËS

Zgjothem

Nëpërmjet shtypjes së tastaturës së kompjuterit,
Para meje hapet bota, t'cilën e mbaj në shuplakë dore

Si një libër

Sa e vogël është ajo-them unë

Dhe shfletoj faqen e parë

Ku janë mesazhet e kohës.

Pastaj eci me hapa të mëdhenj,

Dhe shikoj ato që m'pëlqejnë

Madje edhe ato që s'më pëlqejnë

Bota e kohë sime,

Merr frymë nëpërmjet tastaturave të kompjuterit

Ku shkarkojmë mendimet e kohës

Dhe na kap rrebeshi i tyre...

Pa fjalë, heshtje

Pa fjalë, heshtje,

Unë dhe bota ballë për ballë

I masim forcat e mosarsyes.

Mua më humb shikimi.

Dhe përkundem n' kotësinë e hiçit.

Dikush hap dritaren.

Jashtë fërfëllin era, e zogjtë jetojnë si miliona vjet më parë.

Ky është libri i llogarive
Nëpër gacat e kohës shoh njollat e zeza
Si rriten mbi kokën time
Ku u dogjën gishtërinjtë e gjatë
E fjalët e botës u mblodhën
Si fshehtësitë në Kutinë e Pandorës.

TALLJE NË TEMPULL

Aty është tregu i dhimbjeve, ku stuhia lëshoi shtat
Pingul e n' zemër të kohës bie mashtrimi,
Si bie lisi pa rrënjë e përplaset në hullinë e tokës

Ylli lajmëtar humb shkëlqimin
Është agim i kthjellët
Një dijetar i shtangur me thesin e shqyer drejt tij lundron.

Toka u nda në dysh, qielli shkrepitima lëshoi.
Teksa para Krishtit batakçinjtë përkulen.

Para se toka të ndahej në dysh
Qielli të errej nga një re e zezë trishtuese.
Dhe mbretërit të mbledhur kruspull
Në godinat e mashtrimit.
Ku bluhen fjalët
Në takimet më absurde të hamendësimeve
Të lajnë duart e shfajësisë, e pafajësisë, e tradhtisë,

Sa herë duhet tempulli të rrënohet
E nga hiri të ngrihen ide
Që zëvendësojnë tempullin e përjetshëm .

Dhe kohën që tani është afër.

HUMBJA E KUJTESËS

Edhe kjo natë iku. Ti u zgjove e djersitur
Nuk shpjegove ëndrrat plot ankth,
As pëshpërimat n'muzg,
Veç t'u kujtua përpjekja e makthshme për ta ndryshuar vetveten,
N' momentin kur frika u përbirua n' trupin tënd deri në asht.
Pastaj lëvizjet, për të gjetur rrugën e shpëtimit
Nga shartimi i vetvetes.

Papritmas, para pasqyrës, u duke si pas një tërmeti,
duke i lexuar deformimet, shartimet,
çdo gjë ishte ndryshe,

gjymtyrët e shumëfishuara si nëpër tabela shumëzimi
aty ku sytë e mëdhenj humbin shkëlqimin nëpër vetullat e trasha
si pika e ujit në një sipërfaqe t' madhe
E goja merr formën e një skëterre gllabëruese.
Atëherë, ty të rrodhën disa fjalë të çrregullta,
Për zanafillën
Për rrugën e deformuar
Atëherë kur ishe ti,
Dhe emrin që ta vodhi era,
Para një personi syzat e së cilit ishin avulluar
U ndërruan shkronjat e jetës
Si nëpër pokerë.
N' atë vend putheshin lumenjtë e harresës
Që shtegtonin rrugëve të mjegullta
Duke e lypur daljen.
Ti prapë ke rënë n'gjumë.

DALLGËT E KOHËS...

Hemingway-ane

Është një det i trazuar
Dhe një plak që peshkon pa u ndalur
Me anijen e kohës së amshuar
Brigjet i kërkon papra.
Një re e zezë e përcjell me hapa të harlisur
Peshkun e jetës detit të dalldisur.
Është një det i trazuar dhe shumë çudira ka
Ka dhe një plak që peshkon pa u ndalur
Dhe një vajzë të dashuruar
Që peshkun e artë n'dorë dëshiron ta ketë.
Dhe ky det i trazuar
Asnjëherë s' ka qetësi
Lufton fytas me jetën
Një anije e sulmuar
Nga shumë stuhi.
Në thellësi të mistershme detit në stuhi
Një peshkaqen i uritur kërcënon papra.
Ndërsa një anije e prishur sfidon pa u ndalur.
Dimri i acartë e ngrin detin gur
Dhe furtuna rritet nuk pushon kurrë.

Plaku i harlisur s'e sheh më kohën rreth tij.
Klith anktshëm dhe numëron vitet nëpër gishtërinj
Është natë e zezë deti s'ka qetësi.
I dremitur nga peshkimi ndalet e mendon
Është fundi i jetës, tani një gjë e kupton
S' kishte lindur për të qenë peshkatar njerëzish.
As shkëmb për ndërtim.
Mirëpo dhembshurinë për jetën e ktheu në lundrim.
Janë ditë të ftohta akulli të trishton
Brigjet janë të largëta s'ka dallgë që e shpëton.
Anija e kohës e sfiduar lundron.
Ajo tundet si era me plakun e topitur.
Derisa dielli t'bjerrë mbi det
E vajza të kapë peshkun, tej mase e uritur.
Akuarium i kujtimeve i është bërë hije
Gërmadhë e zemrës së mallëngjyer.
Një strehë e madhe dhembshurie.

PËRCIPTAZI

Tymi shungullon e një kreshtë malesh mbi mua ndërton
Ku luhartet koka ime si gota e zbrazur e rakisë n'dorën e lodhur.
Ku cakërrojmë gotat e krijojmë tym mbi ne
Dhe përciptazi lexojmë poezitë e tua e poezitë e mia.
Jashtë bie shi e bubullimat s'kanë të ndalur.
Ti thua: përciptazi tymi po ecë mbi poezitë e mia,
Del nga flaka e tyre e nga zjarri që s'duket,
Nga gacat që t'djegin duart e nxehta e shikimin e ftohtë
Mbi të cilën hahen metaforat e alegoritë.
Padukshëm, papashëm, përciptazi çdo gjë ecë mbi tokë.
Nën qiell përciptazi rrëshqasin këmbët
E gjurmët fshihen pa u krijua mirë.
Unë them poezia ime s'ka tym, as zjarr, s' ka as gaca.

Përciptazi kalon shikimi yt nëpër gotën e rakisë së zbrazët
E mbush me një letër të grisur, lëmsh të bërë
E hap, me sy t'zgardulluar, përciptazi shoh tufën e tymit
Si krijon një re mbi kokën tënde e mbi kokën time.
Dhe sheh pikat e shiut që binin butësisht mbi xhamin e jetës.
Është kohë përciptazi kjo-thua dhe përplas gotën.
Mbi tokë e nën qiell.

KUJTESA

Të vërtetat i radhitë në anën e djathtë
Rrenat në t' majtë.
Mes tyre është një kufi i vogël
Si kutia e fildishtë, ku e mira dhe keqja gjejnë çati.
Kujtesa është streha e vetme në paqe e pa kufij
Ku lule e therra bëjnë jetë paralele
Thua me duart e vockla e shikimin e trazuar
Kujtesa është loja e keqe e kohës
I vetmi vend që i heq maskat
Dhe na tregon fytyrën e vërtetë.
Ajo është lulja e së nesërme
Pengu që i lidh këmbët i njerëzimit
Dhe arsyeja pse mendojmë
Në portat e së cilës
Të gjithë duan të hyjnë si triumfues.

ILUZIONI I KOHËS

E patrembur endet gjuha ime
Në ujëvarën e dridhmave të së shkuarës
Aty ku rri një lot i ngrirë
Që bën hije të frikshme, si një çati e deformuar.

Nata bie e qetë si grua e dashuruar n' shtrat
Ku ushqehen frikshëm iluzionet e përjetësisë
Ku trokasin frikshëm iluzionet e ardhmërisë
Ku frikshëm pëlcastin kohët, e shkrepitjnë zjarr.
Kohët e tretura kalendarëve të grishur.
Atëherë kur rënkimet pushtojnë qiellin.
E toka na ha me merimangat e kalbura
Që na lidhen nëpër këmbë keq.

N' kupë të qiellit fluturon një zog i vetmuar,
Ka lënë folenë e rrënuar nga pluhuri dhe stuhia
Në lartësi vizaton një kuti t' kuqërremtë
S'është e Pandorës, të ligat s'i ka brenda.
Dhe as nuk ushqen iluzionet e përjetësisë
Ai zog është dhe vetëm fluturon, liri kërkon!

Edhe kur nuk kemi vesh të dëgjojmë
Të pabërat nëpër qytetet e pluhurosura
Ku blasfemohet katedrale e dashurisë
Dhe lirisë i vjen erë e qelbur harrimi.
Zogu fluturon, lirinë kërkon.

Të kredhur në besimin e pakufishëm
Nuhasim të trishtuar dashuritë e mëdha
Nëpër libra që ushqejnë kohët e vrasin harresën
Tërë ditën na predikohet si është më keq
Ne emër të qytetit të vdekjes e shpallim veten të marrë
Engjëjt e djallëzuar që si kameleonë i kanë ngjyrat
Tamam si djalli para Krishtit në mundime.

NGREHINA E LOTËVE

Libri im u tret si një gjethe e kalbur vjeshte
Në baltën e trashë që i përpiu kujtimet
Ato shikimet e buta që tremben zogjtë e uritur
Bashkë me fjalët e verës së nxehtë
Që gëlltitën kohën e kokën
Dashurinë e trutë.

U rrënua hiri i kohës e mjegulla e keqe
U bë ushqim për barkun e uritur - mbrëmje e mëngjes.
U nda trishtueshëm qielli- toka u nda keq.
E mjegulla përpiu ankthshëm kujtimet e kohës së kalbur.
Ndërsa ora e përshëndetjes mbeti si flamur disfate
Nëpër gjurmët e anijes që la prapa trishtimin.

Me shpatë Demokleu u pre qenia ime, e qielli u shkreh në vaj.
E qerrja prej ari fluturoi nëpër kaltërsi e iku si vetëtima,
Atje ku zogjtë e mërdhirë trishtueshëm kërkuan strehim.

Dhe nga lotët ngrehina u ngritën e vallëzuan mbi kokat tona,
Teksa një femër gjilakurique bëri homazhe pranë qiellit.
Dhe përkundi ëndrrën e bukur që rritej si merimangë
Nën këmbët e saj ku luante një mace e harlisur
E mbi kokë i rritej bari i kalbur.

Prapa mbeten kujtimet e vizatuara n'qiell si piktura malli,
T' përplasura kokës - tokës sonë, si këngë vaji.
Në thesin e trishtimit që mbajmë mbi supë
Tash e atëbotë kur u nda keq.

KRIJIMI

Zoti, gjashtë ditë krijoi pa u ndalë.
Të shtatën ditë
poetët i futi në Kopshtin e Fshehtësisë
ua mësoi mjeshtërinë e ua caktoi misionin.
Vetëm një gjë qysh atëherë mbeti sekret:
Gjarpri,
Në cilën ditë të krijimit u zvarrit së pari mbi Dhe?

THIRRJE

Muzë, mos fli hape sythin
Dhe më huazo zërin e kangës
Përkulem para teje
Digjem e flakë s'jam
Muzë, në fillim ishte fjala
Dhe fjala ishte gjithçka
Tanimë s'mbet gjë tjetër
Përpos fjala e dashuria
Më dëfto kufirin e jetës dhe vdekjes
Dhe mbretërinë poezisë
Në qytetin tim më kufij e mure
Më dëfto mbretërinë prej urate
Dhe më mëso të bëhem dishepull i fjalës
I muzikës së shpirtit të dëlirë
Që vallëzon kurrë pa ndalë
Më dëfto shumë
Se historia është nyje në këmbë
E shkruar dhe e rishkruar
Nëpërmjet gishtave të dridhur
Për të prodhuar mite
Dhe një kodër rrenash
E pra Muzë, këndo me mua
Dhe dashurinë që vlon
Në metamorfozën e kohës
Më dëfto Zoti im
Se dielli lind për të mirët dhe të këqijtë
Gjuha e zjarrtë shndërrohen në hije
Dhe shikimi im në horizontin e pritjes
Tek rikthen mendjen në ditën e djeshme
Dhe kundron strukturën e kohës
Në pikën e së nesërme

PËRLESHJE

Nganjëherë i kafshoj dhëmbët furishëm
Më mbetet gjuha në dhëmbë nganjëherë,
Me gjilpërë më duhet ta qep atë,
E ëmbla ime, jo pse dua, nganjëherë
Çuditë me veten si i kafshoj ëndrrat.
Hahem me to deri në përgjakje
I kafshoj dhe përleshem me realitetin,
Nëpër net me ëndrra vjeshtore
Dhe pranvera me buzëqeshje dashurore
Hamendja për fitore mbyty trishtimin
I kafshoj ditët, edhe netët i kafshoj,
Të zeza si futa, netët e paperënduara,
Përgjakem krejt nganjëherë,
Me dhëmbët e mi të rëndë, të rëndë,
Sa shkëmbinjtë e Bjeshkëve të Nemuna,
Nganjëherë botën e zë gjumi n' mes të ditës,
Dhe aty përulet miti i fuqisë së qëndresës
Trulloset bota krejt e humbur përkundet,
Harron përuljen e gjurit bota nganjëherë
Bie në gjumë nëpër ninulla ledhatuese
Papritur tretet nga thartira që të qet zorrët
Tëhuajësohet mendja dhe humb imazhin në pasqyrë
Pema e Jetës zë rrugën në mëngjesin me vesë diellore
E unë, nganjëherë i vetmuar përleshem me botën
Dhe përhubem në lakuriqësinë e poezisë

UDHËTIM I VARGUT

Sot do marr rrugën e gjatë, që fund as fillim s'ka,
Më tha vargu sapo përqafova diellin pranveror
Ndërkaq Expresso ime ishte ftohur nga shikimi i thartë

Qielli s'mund të mblidhet në shuplakë,
Me grushta të mbushur plot pasione.
Ndërsa fitorja është ndjenjë e budallenjve

Mirëpo është një mister që nuk hesht:
Ndjenjat e lidhura lak i shpartallon poezia.
Vargu ec, ec edhe nëpër gjak

Stuhive përmbysëse
Varreve djegëse.
Vargu im peng jete
Zhytet në pellgun e harrimit
Dhe e mbyt trishtimin.

POET ME U BA

Mos u bëj poet nëse s'mund të vdesësh

Për secilën fjalë, për secilin varg.

A. Shkreli

Dje jetova për sot poet të bëhem,

Ëndërrova nëpër natën e gjatë që humbi në horizont,

Në natën e veshur me lëkurë muzash recitova dymijë herë këshillën poetit.

U përgjaka në ëndërr, trishtueshëm i kafshova vargjet,

Thonjtë më mbetën në vargje pikëllueshëm

Ndërsa kupa e enigmës për pak sa s' u përplas ballit tim,

Aty ku bluhen mendimet për ty, ku zihet dielli e vullkanet e panumërta.

Në teh të dilemës recitova vetës dymijë herë këshillën e poetit

Me vargje s'mund të prekësh thellësitë e tokës e lartësitë e qiellit

Për vargje nuk vdiqët, thonë të pagdhendurit për poezi

Sot jetoj për nesër poet të bëhem, me qirinj të mbyt terrin kafshues.

*

Mbi Kopenhagë shfaqen re të bardha shiu.

Ngjyra blu s'ka më në qiell.
Ca ide marroqe bredhin nëpër hapësirë
Teksa maratona e kuptimeve peshon rëndë në kozmos

Në majat e poezisë aty ku puthitet qielli me tokë:
Të ecësh nëpër Ferr, Purgator, për në Parajsë s'është gjë e kotë,
Ku sytë e rëndomtë s'shohin gjë, as sytë e kaltër të suedezeve shtatholla.

Vetëm gjunjët e përgjakur dinë të ecin pafundësive,
Dhe sytë e Mona Lizës të shpojnë fortësinë e mureve të mendimeve.

Ca yje të përgjakur pikojnë si kujtime kohësh,
Sa mistershëm pikojnë në ballë të poezisë.

Dhe pra poet m' u bë domethënë
M' u çjerrë sa herë të bjerë shi mbi tokë,
E sa herë të ketë rreze në qiell,
M' u ushqye me vargje. Poet m' u bë,
Domethënë me fluturua sikur zog nëpër qiell,
Me prekë sa e sa thellësi.
Me shkuar te Kodra e Dashurisë,
Ku puthen qielli e toka dhe me pa çka nuk sheh bota.
Ku nuk shkohet me këmbë, veç me gjunjë të sakatosur.
M' u bë poet domethënë me besuar në dashuri.

HARRIMI

Fjalët i mat me milimetra.
Nëpër dorë mëkatarësh dergjet poezia
Mos më qorto shpirti im,
Të kam lodhur me metafora të pakuptimta
Me këto vargje kohësh të zymta.

Fjala e lidhur me harrimin e pistë
Të zhbërjes së rrënjës
Që i mbijnë fletët sikur pemë vjeshte
Për t'u mbyllë në harrim dimëror

Nëpër rrugët e vetmuara
Hapi im sa qielli
Çative me dëborë
E tremb harrimin

Më kot këndojmë këngës së moçme.
Më kotë heronjtë e çartur tkurren vargut modern
Dhe kotsëkoti i vë kuptim vargut
Thellësia është e tretur pa ia kuptuar esencat
Në harrim dimëror që t'i mbin dhëmbët
Baladat legjendat mitet
Shpirtëzimi i zanës
Murosjen e nuses përplot butësi,
Me njërin gji jashtë vetëm për dashuri

Librat e rrënjës janë çekuilibruar
S'mund të përdorë barkun e Kalit të Trojës
Për t'i ikë karvanit të zhbërjes.

Fati i Formulës së Pagëzimit lëngon
Në tokën e tkurrur çdo pranverë.
Oh. Rruga nëpër Ferr është më e shkurtë
Se trishtimi prej harrimi

KUPTIMI

Tek e fundit çfarë kuptimi ka arti
Kur mes gishtave të mi përvijohet shikimi yt
Dhe kalendari i grishur ku Kulla e Babelit u thye keq.
Sot i hutuar kërkoj të di
Si të deshifrohen të pathënat, të pashkruarat,
E të kuptohen marrëzitë e ujitura si lule.

Trazohet arena e mendimeve të bukura si në një skenë mundje.
Mëkatarrë e papenduar ngarendin pas lavdisë
Ditë e natë çirren pa fije turpi nën hijen e mallkimit.

Dhe thonë: ne puthemi pa e ditë efektin e puthjes
E duhemi pa i ditë pasojat.

Më ç'paftyrësi ecet rrugës së djallit,
Me lëkurë të gjarprit veshur për të hijeshuar trupin.

Si dikur edhe sot dikush thumbon e dikush thumbohet

Karikaturat e vdekjes të përdhosin trutë
Ndërkaq misteri i pafund rëndon:
Një mollë e kafshuar natën mbin dhëmbët e prishur
Dita nuk fsheh gjurmët e mëkatit të zi.

Gjarpri s'dihet në cilën ditë të krijimit u zvarrit në Eden
As për misionin e tij nuk mësuam asnjëherë

METAFORA E LEGJENDËS

Notojnë plagët në zjarr tokë e det
Motra e Gjergj Elez Alisë
Me shaminë e djegur flakë ngreh valle
Dhe muzika ia shëron plagët e të vëllait.

Legjendat përplasën me shkëmbinj
Mbi Rozafë gulçon trishtimi
Derisa hija e Gjergjit në Adriatik
Prish ëndrrën e Këlshedrës

Lëngojnë heronjtë-
Adriatiku dhe toka e djegur prush
Nga librat e pluhurosur

Dheu i çartur hapëron
Jeta sillet si në unazë.
Ecim një hap para,
Pastaj përplasemi dy mbrapa

Jeta sillet si në unazë
Shtegun kërkon

Notojnë plagët

Brenda kopertonash librash historish
Pshurrin helmojnë në kokë
Gjarpri të kuq e të zinj

Notojnë plagët
Prej rrufesë pa re
Tokës së sertë i pëlçet gjaku në dhe

Klith koka e kohëra të shumta lidhen lak
Krisma daullesh përplasen në sy
Sytë pasqyrë ku thyhen kohë, ku prehen yllësi

Notojnë plagët sa në qiell sa në det,
Metafora ime e çartur diku në pafundësi pëlçet

Fytyra jote ka dy pamje
Pas kësaj kohe vjen koha tjetër.

SFIDË

Lufto po të mundësh me jetën
Fyta-fytash po të mundësh
Aty ku vrasin legjendat e shekujve grabitës
Po të mundësh lufto me kohët
E braktisur nëpër lumenj të përgjakur
Po të mundësh sfidoje vdekjen
Mbetesh legjendë historike
Fanatizmin nëpër shekuj
Po të mundësh lufto me antikrishtin
Rikryqëzoje në kryq
Po të mundësh bën gjithçka
Gjithçka bën po të mundësh
Gjitha lulet mbjelli në një saksi
Pa aromë do të mbeten
Po të mundësh bëj gjithçka,
Djallin bëje engjëll
Dhe vallëzo me budallenj
Sa trishtim

PËRMBAJTJA

E DIELA E LAURËS	7
GODO NUK VJEN.....	9
GODO VJEN.....	10
GODO ERDHI.....	12
EMIGRANTI.....	13
VAJZA QË E DO POEZINË.....	14
VAJZA QË LEXON KOMEDINË HYJNORE.....	16
MALL.....	17
GJITHMONË DIÇKA MUNGON.....	18
TYM.....	20
KU ISHE, SALOMON?.....	22
MBRETËRIA E DREJTËSISË.....	23
NJË DITË VJESHTË SI KJO.....	24
PORTAT E LIRISË.....	26
MESDITË PRANVERE.....	27
POEZI.....	28
ITAKA SËMBON.....	29
ASGJË.....	31
DILEMË.....	32
SHESHI.....	34
SIPËRFAQJA PA FORMË.....	35
VEGIME.....	36
LUFTËTARI.....	37
QIELLI I FRIKËSUAR.....	38
SHKËLQIM I VAGULLT.....	39
LUFTËRAT BALLKANIKE.....	40
FLAMURI I LIRISË.....	41
GJYQI I PILATIT.....	42

DALLGËT E JETËS.....	43
AROMA E SË VËRTETËS.....	45
UTOPIA.....	46
DITA E RE.....	48
NË STACIONIN E TRENIT.....	49
ANIJA NË DALLGË.....	50
FILOZOFIA E JETËS.....	52
TOKA E PREMTUAR.....	53
ARKA E NOES.....	54
KUR PRISHET PAQJA BIBLIKE.....	55
EVA IME.....	56
FRUTAT E AMSHUARA.....	57
ËNDRRA MË E BUKUR.....	58
MURI I MENDIMEVE.....	59
SHTEGTARI.....	61
KALI I KOBSHËM.....	63
QYTETËRIMI I DASHURISË.....	65
KËNGA E KOHËS.....	69
TUNELI I SABATOS.....	72
TRAZIMET.....	76
QYTETI I AKULLT.....	78
IDENTITETI.....	80
ÇETA E ENGJËJVE.....	82
KRIJIMI I DASHURISË.....	83
NËPËR SHKRETËTIRË.....	84
NË QYTETIN MJEGULLËS.....	85
ARTISTI NË KOHËN TEKNIKE.....	87
LOJA E KUJTESËS.....	89
SKENË E ZBRAZËT.....	91
ATO QË NUK ARRIJMË.....	92
LARTËSIMI.....	95
KOPSHTI I EDENIT.....	96

FOLEJA E DASHURISË	97
DRAMA E DASHURISË.....	98
ALFABETI I DHEMBJEVE.....	100
DIALOG ME DASHURINË.....	101
RRËNOJAT E DASHURISË.....	102
PANAIRET E POEZISË.....	103
ORA E POEZISË.....	105
YLLI.....	107
LIBRI I FYTYRËS.....	108
TALLJE NË TEMPULL.....	110
HUMBJA E KUJTESËS.....	111
DALLGËT E KOHËS.....	112
PËRCIPTAZI.....	114
KUJTESA.....	115
ILUZIONI I KOHËS.....	116
NGREHINA E LOTËVE.....	117
KRIJIMI	118
THIRRJE.....	119
PËRLESHJE.....	120
UDHËTIM I VARGUT	121
POET ME U BA.....	122
HARRIMI	124
KUPTIMI.....	125
METAFORA E LEGJENDËS	126
SFIDË.....	128

Ndue UKAJ
KRIJIMI I DASHURISË

Boton:
Manifestimi Letrar Ndërkombëtar
“DITËT E NAIMIT” - Tetovë

Drejtor: Shaip EMËRLLAHU

www.ditetenaimit.org

Tirazhi: 500 kopje

CIP - Katalogjizimi në publikim
Biblioteka kombëtare dhe universitare “Sv. Kliment Ohridski”, Shkup
XXXXXXXXXXXXXX
KRIJIMI I DASHURISË / Ndue Ukaj, Tetovë: Ditët e Naimit, 2017. - 125 f. : 21 cm.

(Biblioteka HEJZA)
ISBN 978-608-4769-08-8
COBISS.MK-ID